



USHTRIA



Viti i 78-të i botimit Nr. 7 (827914)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 21 shkurt 2025

Ministri Vengu: Korridori VIII, prioritet gjeopolitik me efekt në ekonomi. Mbështetje për një Evropë të fortë dhe të sigurt



» faqe 3



PRESIDENTI I RSH SH.T. Z. BAJRAM BEGAJ DHE SHSHPFA, GJENERALLEJTËNANT ARBEN KINGJI, VIZITOJNË TRUPAT USHTARAKE NË KFOR

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, njëherazi Komandant i Forcave të Armatosura Bajram Begaj, i shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjenerallejtënant Arben Kingji dhe ambasadori i jashtëzakonshëm dhe fuqplotë...


» faqe 2



KAPITEN FETI VOGLI, I PËRJETSHËM NË MEMORIEN E FORCAVE TË ARMATOSURA

Heronjve u këndohen veç këngë! "Shqipet mbjellin paqe në çdo prag./ Ata i kthejnë buzëqeshjen çdo fëmije./ Feti Vogli mbjell lule Shqipërie./ Skënderbegas të rriti ushtria./ Ku rrojnë bashkë nderi dhe lavdia./ O pishtar me drite lirie./ Feti Vogli...

» faqe 5



OPERACIONI "PAGER", SUKSESI I BASHKËPUNIMIT TË IA-S ME HUMINT

Operacioni i 17 shtatorit 2024, do të njihet si depërtimi i parë më i thellë me teknologji, inteligjencë artificiale dhe agjaturën njerëzore të spiunazhit HUMINT brenda "Hesbollah". Tani është e qartë se Izraeli ka shpalosur një plan në...

» faqe 6

Presidenti i RSH Sh.t. z. Bajram Begaj dhe SHSHPFA, gjenerallejtënant Arben Kingji, vizitojnë trupat ushtarake në KFOR

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, njëherazi Komandant i Forcave të Armatosura Bajram Begaj, i shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjenerallejtënant Arben Kingji dhe ambasadori i jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Kosovës Petrit Malaj, vizituan komandën e KFOR-it në Prishtinë, ku u takuan me komandantin e këtij misioni, gjeneralmajor Enrico Barduanin, dhe efektivet shqiptarë që shërbejnë aty.

Me komandantin e KFOR-it, presidenti Begaj diskutoi mbi sfidat e sigurisë me të cilat përballlet Kosova në kontekstin e zhvillimeve, sidomos në Veri të vendit dhe në të gjithë rajonin.

Presidenti i Republikës Sh.t.z. Bajram Begaj i shprehu gjeneralmajor Barduanit mirënjohje për kontributin dhe, gjithashtu, i përcolli falënderimet për vendin e tij, Italinë, e cila ka numrin më të madh të trupave në Kosovë.

Kreu i Shtetit theksoi domosdoshmërinë e pranisë së KFOR-it për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në Kosovë, ndërsa vlerësoi rolin kyç që ky mision ka luajtur deri tani jo vetëm për Kosovën, por edhe për stabilitetin në Ballkan.

Presidenti Begaj i shprehu komandantit të KFOR-it, gjeneralmajorit Enrico Barduanin, mbështetjen e palëkundur të Shqipërisë ndaj NATO-s dhe misionit të KFOR-it, të cilin e cilësoi si “histori suksesi”, si edhe gatishmërinë e Shqipërisë për të rritur numrin e trupave nëse do të jetë e nevojshme.

Shqipëria ka në shërbim të KFOR-it numrin më të madh të efektiveve që marrin pjesë në misionet ndërkombëtare jashtë vendit.

Gjatë takimit me ushtarakët shqiptarë, Presidenti i Republikës Begaj dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjenerallejtënant Arben Kingji, vlerësuan angazhimin dhe përkushtimin e tyre për një shërbim të cilin e çmuan me rëndësi të madhe kombëtare, pasi, krahas kontributit në NATO, për paqen dhe sigurinë, pjesëmarrja e tyre në KFOR i shërben paqes, sigurisë dhe mirëqenies së Kosovës, e cila është prioriteti ynë.

Presidenti Begaj vlerësoi se përmirësimet ligjore dëshmojnë për vëmendjen dhe mbështetjen në rritje të institucioneve ndaj Forcave të Armatosura. “Ju përfaqësoni pjesën më të mirë të shtetit shqiptar, sepse na bëni krenar me veprimtarinë, angazhimin, ndjenjën e përgjegjësisë dhe kontributin tuaj”, – vlerësoi Presidenti Begaj në këtë takim, ku shoqërohej nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjenerallejtënant Arben Kingji, dhe ambasadori i Shqipërisë në Republikën e Kosovës, z. Petrit Malaj.



Nënkolonel Bledar Mesi, pjesëtar i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe i Kombëtares Shqiptare të Atletikës, ka arritur një rezultat të shkëlqyer në Maratonën Ndërkombëtare “Romeo & Zhulieta” në Verona, duke u renditur në vendin e tretë në kategorinë M35+, mes 4000 pjesëmarrësve, përfshirë 200 atletë nga Forcat e Armatosura Italiane. Me kohën 1h 11’ 30’’, ky rezultat përbën edhe rekordin e tij personal (Personal Best).



Nënkolonel Bledar Mesi ‘rrëmben’ trofeun e radhës



Konferenca e 61-të e Sigurisë në Mynih (MSC), mbledhi në Gjermani dhjetëra liderë politikë nga e gjithë bota për të diskutuar mbi sfidat më urgjente të botës. Në këtë konferencë, krah liderëve botërorë, për të diskutuar mbi sfidat e politikës globale të sigurisë ishin dhe kryeministri i Shqipërisë z. Edi Rama, shoqëruar nga ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu.

Më shumë se 100 ministra ishin në listën e të ftuarve në MSC, i cili konsiderohet si një nga forumet më të rëndësishme të politikave të sigurisë në botë.

Përkrah kryeministrit Rama, ministri i Mbrojtjes Vengu në fjalën e tij theksoi rëndësinë e ndër-lidhjes së infrastrukturave kritike në Evropën Juglindore si një kontribuues për sigurinë dhe qëndrueshmërinë. Ministri theksoi se përpjekjet financiare, duhet të shoqërohen me veprime konkrete nga Bashkimi Evropian dhe NATO, për të hapur instrumentet e zhvillimit dhe për të investuar në tërësinë e projekteve infrastrukturore përgjatë korridorit, nga porti i Porto Romanos deri në Detin e Zi, në Varna dhe Burgas.

Ministri Vengu nënvizoi se ky korridor përbën një prioritet të qartë gjeopolitik dhe politik, me efekte të drejtpërdrejta në zhvillimin ekonomik dhe sigurinë rajonale.

Në Konferencën e Sigurisë së Mynihut, ministri Vengu bashkëbisedoi me ekspertët e Institutit për Bashkëpunim dhe Zhvillim mbi mënyrën se si Korridori VIII, mbështet një Europë të sigurt dhe të fortë.

“Ky korridor përbën një prioritet të qartë gjeopolitik dhe politik, me efekte të drejtpërdrejta në zhvillimin ekonomik dhe sigurinë rajonale. I bindur se këmbëngulja jonë, në bashkërendim me aleatët tanë, Italinë, Maqedoninë e Veriut, Bullgarinë dhe Rumaninë, do të shtojë ndërgjegjësimin e BE-së dhe NATO-s për rëndësinë strategjike të Europës Juglindore në projektin evropian”, - u shpreh ministri Vengu.



Ministri Vengu: Korridori VIII, prioritet gjeopolitik me efekt në ekonomi. Mbështetje për një Evropë të fortë dhe të sigurt



Ministri Vengu: Mirënjohje ndaj përkushtimit dhe sakrificës tuaj, vlerë e shtuar e Forcës Ajrore

Ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu mori pjesë në ceremoninë e daljes në lirim të katër ushtarakëve, pilotë dhe teknikë të Forcës Ajrore, që përmbyllën një kapitull të rëndësishëm të jetës së tyre.

Pjesë e ceremonisë ishin komandanti i Forcës Ajrore, gjeneralmajor Ferdinand Dimo, oficerë, nënoficerë dhe punonjës civilë të Forcës Ajrore, si dhe familjarë.

Në fjalën e tij përshëndetëse, ministri Vengu vlerësoi përkushtimin dhe sakrificat e nënkolonel Fasli Spahiut, nënkolonel Pajtim Golemi, major Dhori Martiri, të cilët kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në mbrojtjen e hapësirës ajrore dhe sigurisë së Shqipërisë si dhe përkushtimin e teknikut Bardhok Marku.

Gjatë fjalës së tij, ministri Vengu u shpreh se: “Secili prej tyre ka shkruar një faqe të rëndësishme në historinë e Forcës Ajrore Shqiptare. Dedikimi për atdheun, dedikimi për sigurinë kombëtare është një virtyt, i cili edhe mund të mësohet, edhe mund trashëgohet dhe kjo na jep një përgjegjësi mjaft të madhe kur vjen puna te dedikimi ndaj kapitalit njerëzor pranë FA dhe posaçërisht pranë Forcës Ajrore”, - u shpreh ministri i Mbrojtjes.

Ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, theksoi angazhimin e qeverisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes për përmirësimin e kushteve të punës dhe trajtimit të personelit të Forcës Ajrore: “Qeveria dhe Ministria e Mbrojtjes kanë punuar për të përmirësuar kushtet e



punës dhe trajtimin e pilotëve, teknikëve dhe personelit tjetër mbështetës. Kemi ende shumë punë për të bërë. Është bërë një hap

në këndvështrimin e trajtimit financiar, por kjo nuk do të ndalet me kaq. Është dedikim i kësaj qeverie që të vijojë rritjen e trajtimit financiar

dhe rritjen e mbështetjes shëndetësore dhe sociale për Forcat e Armatosura dhe veçanërisht për Forcën Ajrore, për personelin fluturues dhe mirëmbajtës”, - u shpreh ministri Vengu.

Ministri gjithashtu theksoi prioritetet e tjera të Qeverisë për zhvillimin e forcimin e Forcës Ajrore, duke përfshirë, rritjen e kapaciteteve njerëzore operationale dhe përmirësimin e infrastrukturës, blerjen e avionëve me përdorim të dyfishtë për mbështetje dhe për emergjencë civile, investime në sistemet e komunikimit dhe informacionit në Bazën Ajrore Taktike të NATO-s në Kuçovë apo kompletimin dhe mirëmbajtjen e helikopterëve “Black Hawk”, në bashkëpunim me partnerët strategjikë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.



Ekuipazhi i anijes “Butrinti”, zhvilloi stërvitjen e përbashkët me anijen gjermane FGS “Planet” A4137

Ekuipazhi i anijes “Butrinti”, pjesë e misionit të NATO-s në Detin Egje, zhvilloi një stërvitje të përbashkët me anijen gjermane FGS “Planet” A4137 në ujërat ndërkombëtare. Gjatë kësaj stërvitjeje, të realizuar sipas standardeve të manualeve të NATO-s në det, ekuipazhi i “Butrintit” vlerësoi dhe testoi aftësitë operacionale dhe ndërvepruese me anijet dhe ekuipazhet aleate. Komandanti i CTU-së, Kapiten i Rangut II Janchen Esser, vizitoi anijen “Butrinti” dhe shprehu vlerësimet më të larta për performancën e anijeve shqiptare gjatë realizimit të misioneve në rajonin e përgjegjësisë, në shërbim të Aleancës.



Starton Kursi i 60-të i Avancuar në QAPN

50 kursantë nga të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura nisën rrugëtimin drejt avancimit profesional në Qendrën e Arsimit Profesional të Nënoficerëve. Kursi i 60-të i Avancuar për nënoficerët do të zgjasë 8 javë, ku do të përfshihen në module teorike dhe praktike, duke përvetësuar njohuritë thelbësore për menaxhimin, drejtimin dhe organizimin e mësimit dhe stërvitjes. Në përfundim, kursantët do të jenë gati të marrin përgjegjësitë e zëvendëskomandantit të togës, duke dhënë një kontribut të çmuar në strukturat ku shërbejnë.





Kapiten Feti Vogli, i përjetshëm në memorien e Forcave të Armatosura

Heronjve u këndohen veç këngë!

*Shqipet mbjellin paqe në çdo prag
Ata i kthejnë buzëqeshjen çdo fëmije
Feti Vogli mbjell lule Shqipërie
Skënderbegas të rriti ushtria
Ku rrojnë bashkë nderi dhe lavdia
O pishtar me drite lirie
Feti Vogli prej Shqipërie*

20 shkurti, prej 13 vitesh mbledh familjarë, ushtarakë të cilët kujtojnë me mall dhe dhimbje ndarjen nga jeta në krye të detyrës të Kapiten Feti Voglit. Ai u nda nga jeta gjatë një misioni ushtarak, më 20 shkurt të vitit 2012, pas një misioni të marrë nga komanda amerikane për të shoqëruar një zyrtar të SHBA-së në një shkollë dhe në një spital të Afganistanit. Por u sulmuan nga një taleban, i cili hapi zjarr me mitraloz në drejtim të Feti Voglit që nuk i mbijetoi plagëve. Në këtë sulm, ku mbeti i vdekur Kapiten Feti Vogli, nga të shtënat u plagos rëndë dhe ushtari Aleksandër Peçi.

Kapiten Feti Vogli lindi, më 23.05.1981, në fshatin Baldushk të rrethit të Tiranës. Pas mbarimit të Akademisë Ushtarake në specialitetin Artileri Tokësore, u bë pjesë e Forcave të Armatosura, me detyrë komandant Toge në Brigadën e Stërvitjes të Bazës, Bunavi. Pas kryerjes me sukses të kursit Bazë të Forcave Speciale, më 16 korrik 2005, u bë pjesë e Batalionit të Forcave Speciale me detyrë Komandant Grupi.

Prej datës 1 qershor 2010, kryente detyrën e komandantit të Grupit të Parë Special në kompaninë e Aksioneve Speciale Ujore. Kapiten Feti Vogli ishte një ushtarak karriere i shkëlqyer dhe si rezultat i arritjeve në detyrë ishte dekoruar disa herë me medalje të ndryshme si: Medalja e Karrierës në vitin 2007 nga komandanti i Forcës së Bashkuar; Medalja për Shërbime Ndërkombëtare nga ministri i Mbrojtjes në vitin 2007 dhe Medalje për shërbime të Shquara nga ministri i Mbrojtjes në vitin 2010. Misioni



“Eagle 4” i Forcave Speciale, që la gjurmë të thella dhe kujtohet me krenari nga pjesëtarët e Forcave Speciale, por edhe nga përfaqësues të lartë të shtetit dhe ushtarakë të lartë Amerikanë.

Figura e kapiten Feti Voglit kujtohet dhe nderohet jo vetëm nga personeli i Forcave Speciale, por nga të gjithë strukturat e MM, SHP.

Veprat sublime të njerëzve që bien për idealet e larta të lirisë nuk mund të harrohen, ato kujtohen me respekt dhe përlujë.

E paharruar do mbetet vepra e Dëshmorit të Atdheut kapiten Feti Vogli i rënë në krye të detyrës 13 vite më parë në Afganistan.

Lavdi dhe mirënjohje të përjetshme për sakrificën sublime për të gjithë Dëshmorët e Atdheut!





KOLONEL HYSNI GJERGJI

Operacioni “PAGER”, suksesi i bashkëpunimit të IA-s me HUMINT


Operacioni i 17 shtatorit 2024, do të njihet si depërtimi i parë më i thellë me teknologji, inteligjencë artificiale dhe agjenturën njerëzore të spiunazhit HUMINT brenda “Hesbollah”. Tani është e qartë se Izraeli ka shpalosur një plan në tetor 2024, për të sulmuar dhe shkatërruar udhëheqjen ushtarake të Hezbollahut, nga sulmi me pager deri te disa raunde sulmesh ajrore. Suksesi i Izraelit në vrasjen e Nasrallahut dhe liderëve të tjerë të Hamas si Yahya Sinwar, më 18 tetor, mund të ketë ardhur vetëm pas një depërtimi të inteligjencës agjenturore HUMINT brenda Hezbollahut, i cili është në kontrast dhe dyshim të fortë me gjykimin e gabuar të përgatitjeve të Hamasit përpara 7 tetorit 2024. Izraeli duket qartë se ka punuar me vite duke ndërtuar dhe mbështetur një rrjet agjenturor për të patur pamje gjithëpërfshirëse të Hezbollahut, duke përfshirë IA-në dhe elementë të burimeve njerëzore HUMINT, duke e mbajtur “të fjetur” atë deri tani.

Përveç teorisë së “sajimit” të sulmit të 7 tetorit të 2023, suksesi i inteligjencës ushtarake izraelite në sulmin e përpiktë kundër Nasrallah, sjell një justifikim për dështimin për të identifikuar dhe parandaluar operacionin e Hamasit vitin e kaluar, duke i dhënë besueshmëri teorisë që inteligjenca izraelite ishte më e fokusuar në Liban dhe Iran dhe jo në çështjet e Gazës. Konflikti në Lindjen e Mesme vazhdon të shkatërrojë jetë të panumërta. Ndërsa lufta arrin një fazë të re, të kuptuarit e asaj që po ndodh dhe çfarë vjen më pas, është më e rëndësishme se kurrë. Shumë do të pyesin pse anëtarët e Hezbollahut vazhduan të përdorin pajisjet “pager” për komunikim, në vend të telefonave celularë, në vitin 2024.

Metoda tradicionale e komunikimit ishte më e preferuara e grupit, pikërisht për faktin se nuk ishte teknologjia më e fundit. Kjo sepse, këto pajisje janë të papërgjueshme dhe të pagjurmueshme, në dukje. Udhëheqësi i Hezbollahut, Hassan Nasrallah i vvarë, më 27 shtator 2024, nga një sulm inteligjent i paralajmëroi anëtarët e grupit që të mos mbanin telefona celularë, sepse Izraeli mund t'i përdorte për të gjurmuar lëvizjet e tyre. Nga ana tjetër, ‘paggers’ në teori, nuk paraqesin një problem të tillë. Hezbollahu ka qenë shumë i kujdesshëm me komunikimet, i vetëdijshëm se bisedat e telefonave celularë mund të hakohen dhe gjurmohen lehtësisht, ndërsa paggers do të ishin një alternativë edhe më e vështirë për t'u depërtuar. Një pajisje “pager” njihet gjithashtu edhe si sinjalizues. Janë pajisje komunikacioni me valë që merr dhe shfaq mesazhe alfanumerike ose zanore.

Disa pajisje komunikimi shërbejnë vetëm për të marrë mesazhe, ndërsa “paggers”-at e tjerë marrin por edhe përcjellin, t'u përgjigjen thirrjeve dhe të dërgojnë mesazhe duke përdorur një transmetues të brendshëm. Paggers u zhvilluan në vitet 1950 dhe 1960 dhe u përdorën gjerësisht nga vitet 1980 deri në fund të viteve 1990 dhe në fillim të viteve 2000. Më vonë, në shekullin e 21-të erdhën celularët dhe smartphone-t me aftësi të theksuar për mesazhet me teks, duke bërë që të zvogëlohet ndjeshëm industria për “pager”. Megjithatë, “pagerët” vazhdojnë të përdoren nga disa shërbime të urgjencës dhe personeli i sigurisë publike, sepse mbivendosja e mbulimit të sistemeve moderne të pagerit e kombinuar me përdorimin e komunikimeve satelitore, mund t'i bëjë sistemet ‘pager’ më të besueshme sesa rrjetet celulare me bazë tokësore në disa raste, duke përfshirë këtu fatkeqësitë e shkaktuara nga njeriu. Ky elasticitet në përdorim ka bërë që agjencitë e sigurisë publike të adoptojnë ‘pager’ përpara celularëve dhe pajisjeve të tjera në rastet kur dërgohen mesazhe të rëndësishme së veçantë. Agjencia shtetërore e lajmeve tha se spitalet në Libanin jugor, Luginën lindore Bekaa dhe periferitë jugore të Bejrutit, të gjitha zona ku Hezbollahu ka prani të fortë, kanë bërë thirrje për të dhuruar gjak. Sipas kësaj agjencie, në këto zona, për shpërthimin e pajisjeve ‘paggers’ u përdor teknologji e avancuar dhe për pasojë mbeten të plagosur dhjetëra vetë. Incidenti ndodh në një kohë që tensionet mes Libanit dhe Izraelit janë shtuar. Grupi militant libanez Hezbollah dhe forcat izraelite janë përleshur pothuajse çdo ditë që kur nisi lufta në Gazë, mes Izraelit dhe Hamasit, aleat i Hezbollahut.

Pajisjet elektronike të komunikimit me mesazhe ‘pager’ të përdorura nga qindra anëtarë të grupit militant Hezbollah shpërthyen pothuajse njëkohësisht në Liban dhe Siri me 17 shtator, duke shkaktuar të paktën 12 të vranë, mes tyre dy fëmijë, dhe plagosur mijëra të tjerë, në atë që duket të jetë një sulm i sofistikuar dhe nga distanca. Izraeli e informoi Uashingtonin të martën, pas përfundimit të operacionit, gjatë të cilit u përdoren sasi të vogla eksplozivë të fshehura në pajisjet e komunikimit. Qeveria libaneze dhe Hezbollahu, që mbështetet nga Irani, fajësuan Izraelin për shpërthimet vdekjeprurëse, që kishin për objektiv një numër të madh njerëzish dhe që duket si një operacion i planifikuar prej kohësh. Nuk ka detaje lidhur me ekzekutimin e shpërthimeve.



Ushtria izraelite nuk ka pranuar të komentojë. Ndryshe nga telefonat celularë, këto pajisje shfrytëzojnë të tjera valë komunikimi dhe janë më të përdorshme për raste urgjente. Pajisjet ‘pager’ e ndihmuan Hezbollahun për të anashkaluar survejimin e mundshëm nga Izraeli të telefonisë celulare të Libanit. Ky lloj sulmi do ta detyrojë Hezbollahun që të ndryshojë strategjitë e komunikimit, se të mbijetuarit e shpërthimeve të së martës tani ka të ngjarë që të flakin tej jo vetëm ‘pager’-at e tyre, por edhe telefonat dhe të heqin dorë nga pajisjet portative elektronike.

Kompania tajvaneze “Gold Apollo” deklaroi një ditë pas sulmit se kishte autorizuar firmën “BAC Consulting KFT,” me bazë në Budapest të Hungarisë, që të përdorte markën së saj për prodhimin dhe shitjen e modelit AR-924 të pager-it në fjalë. Firma BAC duket të jetë një kompani guaskë. Që nga viti 2022 deri në gusht 2024, firma “Gold Apollo” ka eksportuar 260,000 pajisje ‘pager’ dhe rreth 40,000 midis janarit dhe gushtit të 2024. Hezbollahu i ka përdorur pajisjet ‘pager’ që nga lufta e vitit 2006 me Izraelin. Por pajisjet e reja të komunikimit me mesazhe ‘pager’ që shpërthyen të martën, më 17 shtator, u blenë në shkurt - mars 2024 dhe nuk dihet se si arritën në Liban. Deri tani kanë qarkulluar teoritë të ndryshme rreth mënyrës së realizimit të shpërthimeve, por ka shumë gjasa për infiltrim në zinxhirin e furnizimit. Në pajisjet e komunikimit ‘pager’ mund jenë vënë mjete shpërthyes shumë të vogla përpara se ato të mbërrinin tek Hezbollahu. Ata mund të ishin aktivizuar njëkohësisht nga distanca, ndoshta përmes një sinjali valor. Kjo konfirmon të dhënat për lëndë shpërthyes të fshehura nëpër pajisje si pjesë e një operacioni izraelit, ku mundet që gjysma e baterisë të ishte eksploziv. Një mjet shpërthyes ka pesë përbërës kryesorë: hapësirën ku vendoset, baterinë, pajisjen ndezëse, kapsollën dhe lëndën shpërthyesë. Një ‘pager’ i ka tre prej përbërësve, duhet vetëm t'i shtosh kapsollën dhe lëndën shpërthyesë. Forca e shpërthimit të ndodhur duket e njëjtë me atë të shkaktuar nga një kapsollë e vetme elektrike, ose nga përfshirja e një sasie shumë të vogël lënde shpërthyesë por me fuqi të madhe. Kjo tregon se ka dorë një aktor i inteligjencës dhe me shumë mundësi shërbimi i famshëm Mossad, pasi ai ka një histori të gjatë të operacioneve të ngjashme në të kaluarën.

Për planifikimin e një sulmi të kësaj shkalle kërkohet shumë kohë dhe ekspertizë e koordinuar, përafërsisht disa muaj deri në dy vjet për organizimin e një aksioni të tillë. Sulmi i ndërlikuar të kuptosh se organizatorët kanë mbledhur të dhëna për një kohë të gjatë. Një sulm i këtij kalibri kërkon ndërtimin e marrëdhënieve të

nevojshme për të patur edhe qasje fizike të personave të shënjestruar tek pajisjet përpara shitjes së tyre. Pajisjet kishin filluar të vibronin pa pushim pas një mesazhi të gabuar, duke i detyruar përdoruesit që të përdornin të dyja duart për të shtypur butonat me qëllim për të ndaluar dridhjet e aparatit. Dërgimi i mesazhit të gabuar, jo vetëm që rriti efektin e shpërthimit, por gjithashtu siguroi që përdoruesi të kishte në dorë pajisjen, duke u përpjekur ta fikë atë.

Njëqind bomba të drejtuara u përdorën nga forcat ajrore izraelite në sulmin ajror të 27 shtatorit në mbremje ku Hassan Nasrallah, në një kompleks nëntokësor të fshehur në periferinë jugore të Bejrutit. Nasrallah, ishte i kujdesshëm deri në paranojë në lidhje me masat e tij të sigurisë dhe rrallë shfaqej në publik, do të ketë dhënë pak njoftim për planin e tij për udhëtimin fatal në takim. Por depërtimi i inteligjencës izraelite ishte aq i thellë sa Izraeli e dinte se Nasrallah dhe anëtarë të tjerë të mbijetuar të Hezbollahut do të takoheshin në vendin e supozuar sekret. Roli i HUMINIT sado që zhvillohet teknologjia dhe sofistikohen komunikimet, mbetet shumë i rëndësishëm dhe i pazëvendësueshëm.

Raportet e planifikimit pas sulmit tregojnë se Izraeli kishte nën vëzhgim vendndodhjen e Nasrallah për disa kohë. Komandanti i skuadriljes 69-të të avionëve F-15I që kryen sulmin, i quajtur në mediat izraelite vetëm si nënkoloneli M, ishin të armatosur për të goditur dhe shkatërruar thellë nën tokë, duke kërkuar një sasi të madhe eksplozivë, të aftë për të eliminuar ndërtesat sipër vendstrehimit. Operacioni i quajtur Rendi i Ri, përdori rreth 100 bomba, të cilat hidheshin çdo 2 sekonda. Katër ndërtesa banimi u goditën, tre u shkatërruan plotësisht, duke lënë pas vetëm kraterë.

Vlerësimet fillestare në terren janë se 300 njerëz mund të jenë vranë, megjithëse numërimi zyrtar i Libanit ishte se 11 u vranë dhe 108 u plagosën. Izraeli tha se kishte vranë më shumë se 20 anëtarë të Hezbollahut dhe se sulmi ishte i justifikuar sepse “Nasrallah ndërtoi qëllimisht selinë qendrore të Hezbollahut nën ndërtesat e banimit në Dahiya”. Gjenerali Amichai Levine, komandanti i bazës ajrore Hazerim, ku është vendosur skuadrilja e 69-të, e përshkroi shkurt si “operacione eliminimi” ku ishte inteligjenca e saktë. Një pyetje që lind është pse Nasrallah e ndjeu të nevojshme të takonte personalisht anëtarë të tjerë të Hezbollahut. Ishte 10 ditë më parë që lufta e Izraelit kundër Hezbollahut u përshkallëzua me shpërthimet e pagerëve të sabotuar dhe radiove të përdorura nga grupi militant që mund të ketë plagosur deri në 1500 vetë. Me mosbesimin e të gjitha mjeteve elektronike, një takim ballë për ballë mund të ketë qenë mënyra e vetme për të diskutuar me bashkëpunëtorët e ngushtë.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Korça është një nga qytetet më të dashura dhe romantike të Shqipërisë, shpesh e quajtur “Qyteti i Serenatave”. Ajo ka një kulturë të pasur, një histori të thellë dhe një atmosferë unike që të bën të ndihesh si në një botë tjetër. Teksa shëtit në rrugët me kalldrëm të Korçës, ndjen një kombinim magjik mes nostalgjisë dhe dashurisë për jetën.

Qyteti ka një ngrohtësi shpirtërore që vjen nga njerëzit e tij të butë, nga aromat e verës dhe birrës tradicionale, nga tingujt e serenatave dhe nga trashëgimia kulturore e pasur.

Dimri e mbulon qytetin me borë, duke i dhënë një atmosferë përrallore, ndërsa vera e mbush me gjallëri, me festa, muzikë dhe plot ngjyra.

Serenatat e Korçës – Shpirti i Qytetit

Serenatat janë simbol i qytetit dhe një nga aspektet më romantike të kulturës korçare. Ato janë këngë dashurie të kënduara nën dritën e hënës, shpesh të shoqëruara me kitarë dhe mandolinë.

Ato i këndojnë dashurisë së pastër, mallit dhe ndjenjave të forta që ndihen në çdo varg e melodi. Tradicionalisht, djemtë i këndonin vajzave poshtë dritares së tyre, një zakon që i jep qytetit një ndjenjë të rrallë romantike.

Korça ka qenë gjithmonë një vatër e kulturës dhe arsimit në Shqipëri. Këtu u hap shkolla e parë shqipe në vitin 1887, duke e bërë qytetin një pikë kyçe në zhvillimin e gjuhës dhe edukimit shqiptar.

Korça është më shumë se një qytet, është një ndjenjë!

Nëse e ke vizituar, e kupton menjëherë, nëse jo, atëherë është koha ta përjetosh magjinë e saj.

Të jetosh në një qytet në formë zemre, jeton jetën nga e para...

Korça nuk është thjesht një qytet, është një ndjenjë e pastër, një përqafim i ngrohtë mes rrugëve me kalldrëm, kitarave të serenatave dhe aromës së trëndafilave, shpërthyer haresh oborreve të shtëpive hijerënda. Ajo të fal romancë, kulturë dhe një ritëm jete ndryshe, një jetë më e ngadaltë, më e thellë, me plot kuptim.

Në këtë qytet, çdo mëngjes ka shijen e kafesë së ngrohtë në një lokal të vogël të Pazarit të Vjetër, çdo mbrëmje është një serenatë që të prek shpirtin, dhe çdo stinë ka magjinë e saj, nga bora e butë dimërore te verërat e ngrohta e plot gjallëri.

Të jetosh në Korçë është si të rilindësh

Të kthehesh pas në kohë, por edhe të ndihesh pjesë e një bote moderne, ku e vjetra dhe e reja takohen në mënyrën më të bukur. Nëse ke jetuar ose ke vizituar Korçën, e di se çfarë ndjesie është... Ajo nuk të lë të largohesh pa marrë me vete një copëz dashurie nga ajo zemër e madhe.

Sepse Korça nuk është vetëm një qytet, është një kujtim që mbetet thellë në shpirt. Çdo hap në rrugicat e saj të sjell një melodi, një aromë, një histori.

Një melodi që të përkëdhel shpirtin me serenata të ëmbla... Një histori dashurie mes kalldrëmeve, dritareve të vjetra dhe zemrave të hapura...

Korça është ajo ndjesi që të mbetet Brenda, një përqafim i ngrohtë që nuk e harron kurrë. Dhe kur largohesh, e di që një ditë do të kthehesh... sepse ajo të thërret gjithmonë pas!

Korça nuk është thjesht një qytet, është një prekje e butë në shpirt

Është ajo ndjenjë e paqte që të mbështjell si një shall i ngrohtë dimri, ajo nostalgji që të shoqëron edhe kur je larg, ajo ëmbëlsi që të bën të rikthehesh gjithmonë... Sepse në Korçë, çdo gur i kalldrëmit mban kujtimet e një kohe të artë, çdo melodi e serenatave të flet për dashurinë e vërtetë, çdo gotë birrë apo lakror i pjekur në saç të kujton shijen e jetës së thjeshtë, por të bukur.

Dhe kur largohem, e di...

Korça nuk më lë të shkoj pa marrë me vete një copëz zemre. Sokakët e tua, Korçë... çdo gur ka një histori. Në çdo hap që hedh mbi kalldrëmin tënd, ndien gjurmët e kohës, përsëndet ëndrrat e dikurshme, dëgjon jehonën e serenatave që ende dridhen në ajër... Në muret e vjetra flasin kujtimet, dashuritë e fshehta pas penxhereve, takimet e dikurshme në dritën e hënës, hapat e ngadaltë të atyre që kurrë nuk të harruan.

Në sokakët e tua, Korçë, historia nuk është vetëm në libra, ajo frymon në çdo rrugicë, në çdo dritare, në çdo gur të vogël që

Pse të dua Korça ime?



mban brenda një copëz zemre.

Miqve iu them: Shkoni në Korçë, sepse do të gjeni veten e humbur...

Humbuni në rrugicat me kalldrëm, në gotën e parë të verës së butë, në tingujt e kitarës që këndon një serenatë të vjetër... në buzëqeshjen e njerëzve të butë, në përqafimin e një qyteti që të pranon si të tijin.

Dhe pikërisht aty, në mes të kësaj magjie, do të gjeni veten... atë veten që e kishit harruar diku mes zhurmës së botës, por që Korça e mban mend dhe ju ndihmon ta rizbuloni.

Dashuria e parë e ka emrin Korçë...

Sepse si dashuria e parë, të magjeps menjëherë, të rrëmben me butësinë e saj,

të fton ta përjetosh, ta ndjesh, ta duash me gjithë shpirt. Korça është ajo ndjenjë e pastër që të mbetet në zemër, ai kujtim që kurrë

nuk zbehet, ajo melodi që e këndon pa e kuptuar... Si dashuria e parë, të mëson të ndjesh thellë, të ecësh ngadalë mes sokakëve të saj, të shijosh çdo çast, çdo aromë, çdo tingull. Dhe ashtu si ajo dashuri e paharruar... edhe nëse largohesh, Korçën do ta mbash gjithmonë me vete!

Korçë, apo Shën Valentin?

Nëse ka një vend ku çdo ditë ndihet si Shën Valentin, ai është Korça... Sepse dashuria nuk matet me një datë në kalendar, por me tingujt e një serenate të kënduar nën dritën e hënës, me shijen e një vere të ëmbël të pirë me dikë të zemrës, me një shëtitje dorë për dore nëpër rrugicat me kalldrëm.

Në Korçë, romanca është në ajër, jo vetëm më 14 shkurt, por çdo ditë të vitit. Ndaj, s'ka rëndësi nëse është festa e të dashuruarve apo një ditë e zakonshme...

Në Korçë, dashuria ndodh vetë.





Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Në përkujtim të dëshmorit të Atdheut Kutbi Gjeçi (25.2.1924 Fushëbardhë – ra më 25.7.1944 në Dukaj të Tepelenës), me rastin e 101-vjetorit të lindjes dhe 81-vjetorin e rënies në fushën e nderit, si dhe në kuadrin e vitit historik të 80-vjetorit të fitores mbi nazi-fashizmin, ndërkohë që eshtrat e dëshmorit Kutbi Gjeçi prehen në varrezat e dëshmorëve në Gjirokastrë. Kutbi Çelo Gjeçi është i shpallur me titullin e lartë “Dëshmor i Atdheut” me Vendim nr.65 datë 2.10.1971 të ish-Komitetit Ekzekutiv të Rrethit Gjirokastrë si dhe është i njohur me titullin e lartë “Dëshmor” sipas parametrave e standardeve zyrtare shtetërore.

Kutbi Gjeçi ishte lindur në fund shkurtin e vitit 25.2.1924 (sipas së motrës së tij, Hamidesë) në Fushëbardhë të Gjirokastrës. Ai lindi në një familje patriote dhe atdhetare me tradita dhe me zakone. Mësimet e para i mori në shkollën fillore të fshatit në Fushëbardhë. E pati mbaruar filloren me rezultate të shkëlqyera, sepse dhe i donte shumë librat, sipas thënieve të brezave që e njohën atë. Kutbiu e kalonte shpesh herë natën duke lexuar pranë vatrës së zjarrit, që ndriçonte më fort se kandili i vajgurit. Babai i Kutbiut, Çelua ishte një burrë zakonli, meshollë, i dobët në shëndet por i lidhur mirë ose si i thonë në Fushëbardhë “trup i thantë”, i cili për të përballuar hallat e kohës merrej me tregti ambulante në fshatrat e Labërisë dhe më gjerë. Çelo Gjeçi së bashku me bashkëshorten Shelege Gjeçi (Zervoi që ishte e motra e Hader Zervoi), kishin katër djem dhe dy vajza. Të parat ishin vajzat më të mëdha: Hamideja e martuar në Shehaj të Fushëbardhës (që kishte 5 djem) si dhe motra tjetër e saj, e madhe e cila u martua në Vergo dhe jetuan në Vlorë, ku rritën dy vajza dhe një djalë. Më tej, në vitin 1919, lindi Muharremi, ndërsa Kutbiu lindi në shkurt 1924, (sipas tregimeve të motrës së tij); (megjithëse ka edhe një version tjetër si vitlindje më 1926); Xheveti lindi më 1929, Ulsiu më 1934. Çeloja pati shtëpi në Fushëbardhë dhe një haur në fushë në Vërri, ku deri vonë është quajtur bregu i Gjeçajve në anë të Gurrës, dhe që ishin komshi me Asllan Muhon, Qamil Muhon etj., përbrri kishin Pashako Mullain, që shkonin vëllazërisht në fqinjësi të mirë. Ish-bashkëkohësit e dëshmorit, si dhe pasardhësit e tyre kujtojnë se, “Njëra nga mushkat ishte me huqe, e cila mund të ecte normalisht vetëm po të kish një njeri mbi samar edhe kur qe me ngarkesë”, prandaj babai i Kutbiut, Çelo Gjeçi detyrohej të merrte me vete njërin nga djemtë, Kutbiun ose Xhevetin. Ai ishte gjithmonë i armatosur, mbante gjithmonë një pistoletë me vete, se “nuk e duroj dot thikën”, thoshte shpesh. Takëmet e kafenë i merrte përherë me vete dhe e ngrinte konakun ku ta zinte hera, duke respektuar traditën ku kishte ujë, ku kishte shesh pamje dhe duke eliminuar pusitë e mundshme. Edhe pse duhet thënë se miqësinë e kishte të gjerë në çdo fshat të Labërisë e më gjerë, kudo ku kalonte nga Vlora në Tepelenë, në Gjirokastrë, në Përmet, Zagori, Libohovë, Delvinë e Sarandë. Mbante dhe 10-15 kokë dhi, të cilat në dimër i ulnin në Fushëvërri (sepse Fushëbardhën e zinte dëbora në dimër), por mbante edhe 10-15 kohëre bletë, sa për familjen e tij dhe për miqtë. Kur kaloi në moshë shtëpinë e administronte djali i madh Muharremi 24 vjeçar, i cili qe martuar në vitin 1943. Por mbi të gjitha sikurse tregohet në gojëdhënë e fshatit, krahinës dhe më gjerë në Labëri ai ishte një shpirt njeriu zemër e shpirtbardhë gjithmonë bukëdhënë, që mikut i thoshte mik dhe i qëndronte vazhdimisht në besë përjetësisht, bile edhe duke e trashëguar miqësinë brez pas brezi. E ngarkonte dy mushka me basma dhe me mallra të tjera në Gjirokastrë dhe i binte trevës së Labërisë kryq e tërthor. Ngarkonte në Vlorë dhe arrinte në Tepelenë. Çelo pramatari (tregtari) ishte i kudondodhur, por edhe mjaft i njohur. Pas merrte shpesh edhe djemtë kështu që i takonte edhe djalit të mesëm të Celos, Kutbiut që të ndiqte pas të atin. Në vitin e përfundimit të luftës italo-greke, pëllhurat tregtarët i shkëmbenin me armë. Kjo ndodhte sepse në malet e Labërisë menjëherë pas shkrehjes së frontit të luftës mbetën sheshit armatime të shumta si dhe municione të shumë kalibrave. Dhe padyshim labëve e sidomos Kudbiut, u zilepsej armatimit, pasi e kishin traditë nga të parët, që “armët mbahen gjithmonë gati për çdo lloj situatë”. Prandaj ai shpesh ngarkonte kalin me armatim dhe e çonte në Fushëbardhë e Fushëvërri, i këmbente armët me bereqet dhe i fshihte në shpellën e Zhulit në krye të fshatit Fushëbardhë. Me ato armë u armatosën djemtë e fshatit tonë si dhe njëmbëdhjetë vajza partizane të Fushëbardhës. Çetës “Çerçiz Topulli” të Fushëbardhës Kutbiu i vogël i kishte gjetur edhe një mortajë me disa predha (mina mortajash) që fillimisht partizanët e çetës e quanin “topi” i çetës “Çerçiz Topulli”. Nga armët që kishte mbledhur Kutbiu zgjodhi një pushkë të prodhimit të vitit 1942, e cila ishte tepër precize në të shtënë e shkurtër, “novantauno”, por pak më e gjatë se pushka “xhuxh” e topçinjve. Për Kutbiun shpejt fronti i luftës do të ishte drejtimi i pakthyesëm, sepse pothuaj të gjithë shokët kishin dalë malit dhe kishin mbushur formacionet antifashiste partizane. Shumë shpejt llogorja e luftës u kthye në shtëpinë e tij. As fotografi nuk kishte, por kur ra dëshmor, një student i Arteve të Bukura të Universitetit të Tiranës i bëri një portret vetëm me përshkrimet e shokëve të luftës. Kur doli malit Kutbiu kishte veshur një palë këpuccë që ia kishte falur një këpucar gjirokastrit, kur çeta ku bënte pjesë Kutbiu hyri në qytetin e gurtë. Mbante gjithashtu veshur një xhakëtë ushtari “italiane” që e kishte marrë në një depo kur u dorëzua Divizioni Italian “Peruxhia”, xhakëtë që në një vit luftë ishte tretur, sepse në shi dhe në llojë kalonin ditët dhe netët partizane; por edhe një kapele me yll në ballë. Mbante çorape leshi të gjata gjer te gjuri që ia dërgonte e motra Hamideja (Hamidea). Gjerdanin e fishekëve e mbante në dy radhë ballësh me fishekë dhe e lëshonte nga supi i majtë, kryq në gjoks. Të gjitha këto të dhëna shokët e tij që mbetën gjallë nga LANÇ-i, ia tregonin gojë më gojë brezave dhe sot kemi një portret të tij vetëm me këto të

KUTBI GJEÇI, dëshmori që shkroi me gjak lirinë e Shqipërisë



dhëna. Ndërsa familjarët thonë se piktura e dëshmorit Kutbi Gjeçi që ekziston te libri “Yje të pashuar” ishte pak a shumë, në mos fiks, si busti “Ushtari i panjohur”, në Tiranë.

Partizan fushëbardhas i BrVIS, që ngeli përjetësisht në lavdinë e luftës partizane

Lufta partizane është epopeja më e lavdishme e shqiptarëve përgjatë LIIB. Partizanët shqiptarë u shndërruan në forca më vitale e luftës në Shqipëri. Fakt është se rinia shqiptare fokusin e luftës kundër fashizmit e shikonte zgjidhje tek krahu i majtë partizan që mbushën malet me djalëri të mbushur me ideale antifashiste. Vetë termi “partizan” është përdorur nga francezët për herë të parë që në shekullin e 17-të. Termi francez “partisan”, vjen nga latinishtja, dhe përkshkruan “drejtuesin e një beteje/luftë”. Në Shqipëri termi “partizan” ishte luftëtar/i ja antifashiste e UNÇSH-së, që ishte ngritur në luftë për të çliruar vendin nga pushtuesit nazifashistë. Lufta partizane mori hov në Shqipëri pas njësiteve guerile, krijimit të çetave, batalioneve, brigadave, divizioneve e korparmatave. Për Fushëbardhën e Kutbi Gjeçit, për krahinën e Kardhiqit zanafilla e luftës nisi me krijimin e çetës partizane “Çerçiz Topulli” ndër të parat çeta partizane në Shqipëri, çetë që u krijua më 12.12.1942. Fushëbardha u kthye streha e formacioneve partizane e çetave, batalioneve e brigadave partizane. Bijtë e Fushëbardhës e vlerësuan situatën, zgjuan instinktin e shekujve të shqiptarëve, rebelimin ndaj pushtuesve, duke shkaktuar një stuhi lufte të kristaltë, luftë ideale të pastra, luftë që ia shtoi krenarinë shqiptarëve, duke e rënditur vendin në krahun e duhur të historisë, luftë që ndaloj copëtimin e Shqipërisë pas kësaj Luftime, luftë që u mundësoi shqiptarëve të kërkonin llogari në Konferencën e Paqes në Paris, më 1946 dhe jo të jepnin llogari si humbës. Çeta partizane “Çerçiz Topulli” u bë pjesë e batalionit “Asim Zeneli” (7.8.1943) dhe që ky batalion u bë pjesë e BrVIS (26.1.1944). Kështu dhe partizanët e Fushëbardhës u bënë pjesë e brigadës së gjashtë sulmuese, brigadë ku luftoi Kutbiu, Xhezua, Alemi, Tahiri, Latifeja...”. Partizanët dhe populli këtë brigadë e emërtuan: “Brigada që tundi dhenë./në popull ngriti folenë./atje jataku dhe shpirti./lavdinë më lartë e ngriti./... Brigada e VI-të u themelua nga batalioni “Asim Zeneli”, i krijuar në rrapet e Kardhiqit e Prongjisë, më 7.8.1943, batalioni “Baba Abaz” krijuar në Kalivaç të Tepelenës më 10.8.1943, batalioni “Naim Frashëri” në Garzema të Përmetit më 21.9.1943, batalioni “Abaz Shehu” i krijuar më 12.12.1943 në Fushëbardhë, pas ndarjes së batalionit “Asim Zeneli”, si dhe batalioni i pestë ishte batalioni partizan “Zaho Koka”, që u bashkua më vonë. Luftëtarët partizanë të këtyre pesë batalioneve kishin marrë pjesë në luftimet kundër forcave fashisto-naziste si në Cepo, Ura e Kardhiqit, Libohovë, Shkallë të Zezë, Tepelenë, Mezhgoran, Këçok, Rrëzomë, Kurvelesh, Mesaplik etj., Brigada e VI Sulmuese “Heroinë e Popullit”, numëronte fillimisht 912 partizanë nga të cilët 120 vajza e gra dhe 60 pionierë lufte, ndërkohë që efektivit i saj u rrit në 1700 luftëtarë. Drejtuesit e brigadës e shkruan biografinë e tyre me luftime të përgjakshme, por të suksesshme. Në kohën e krijimit BrVIS kishte: komandant Tahir Kadareja, nënkomandant Jaho Gjolliku, komisar Mustafa Matohiti, zv/komisar Haki Toska; më seksionin politik Adil Çarçani, Zihni Sako, Sami Gjebero, Siri Çarçani, Vangjelo Sotiriadhi, intendent Hetem Pogaçe e ndihmës Braho Toto, për shëndetësinë Nedin Kalanxhi, ndihmësmjek, për ndërlidhjen Muhedin Bakiri, komandant batalionesh ishin Riza Veipi, Sadik Buzo, Fejzo Ismaili, Feti Bubsj, Maksut Myrtaj, nënkomandantë batalionesh Astrit Nishani, Musa Daci, Mustafa Asllani, Meleq Gostinishti, zëvendëskomisar batalionesh Ago Çeli, Veledin Zeneli, Petrit Radovicka, Mitro Xhani, Abdul Hakiu, Asaf Dragoti,...e kuadro të tjerë si Sotir Filto, Xhule Çiraku etj., që spikatën në betejat e shumta të kësaj brigade. Lufta e partizanëve të BrVIS çliroi 8 qytete e 32 krahina, që përmes luftimesh të përgjakshme të 5 batalioneve të saj në një rrugëtim historik luftimesh prej 3700 km ndoqi nazistët deri në Vishegrad, por la në fushën e nderit 220 “Dëshmorë të Atdheut” dhe 10 “Heronj të Popullit”, që dhanë jetën për lirinë e Shqipërisë, por që pati edhe 540 partizanë të plagosur, disa nga të cilët ndërruan

jetë nga plagët e marra në luftë dhe që në bazë të ligjit meritojnë titullin e lartë “Dëshmor”. Nga Fushëbardha ka pasur me dhjetëra bijë e bija që kanë ngelur emra të gdhendur në historinë krahinore dhe kombëtare, ku vetëm nga Fushëbardha kanë rënë dëshmorë nga formacioni i BrVIS pesë dëshmorë: Kutbi Çelo Gjeçi (25.7.1944), Alem Zano Shehu e Tahir Reis Xhuvani të dy kushërinj të parë që ranë më (15.4.1944), Xhezo Dervish Proda (10.9.1944), Latife Veli Nora (25.3.1945) në Suhagorë të Bosnjë Hercegovinës. BrVIS ishte një nga formacionet më të lavdishme të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, që u shndërrua në simbolin e rezistencën antifashiste të shqiptarëve. Me betejat e zhvilluara kjo brigadë shkroi me germa të arta historinë e saj. Shqipëria ishte ndër vendet e para të Europës që u çlirua tërësisht nga pushtuesit nazifashistë, si një meritë të padiskutueshme i takon partizanëve të Brigadës VI Sulmuese, që u bë Brigada epope lavdie e LANÇ-it, që luftoi 308 ditë lufte në Shqipëri dhe 371 ditë të tjera lufte në ish-Jugosllavi. Nuk është e rastit që analistët e luftërave, në Shqipëri dhe jo vetëm, shkruajnë se: “Pa LANÇ-in, nuk do ekzistonte Shqipëria”, pasi epopeja e luftërave në botë ka fshirë shumë kombe nga faqja e dheut. Ndërkohë që epopeja shqiptare e luftës çlirimtare dhe antifashiste është çimentuar me gjakun e dëshmorëve të Fushëbardhës, Labërisë, Shqipërisë. Brigada ku luftoi Kutbi Gjeçi lindi u rrit dhe u konsolidua në zjarrin e betejave për liri gjatë LIIB, ku UNÇSH shkroi historinë e një prej luftërave më të organizuara të shqiptarëve. Kënga për brigadën ku luftoi Kutbiu gjëmon edhe sot nga mbrojtësit e idealeve të drejta të LANÇ-it: “Dil nëno dhe shiko jashtë./si lufton Brigada e gjashtë./Trimat tanë të Shqipërisë./sollën dritën e lirisë./në këtë tokë plumb të rëndë./me mençuri, pushkë dhe këngë... Në themele të historisë së shqiptarëve është çimentuar gjaku i dëshmorëve, gjaku i dëshmorit Kutbi Çelo Gjeçi dhe dëshmorëve të tjerë të Shqipërisë.

Partizani fushëbardhas mes 11 dëshmorëve të rënë në Dukaj të Tepelenës

Kutbi Gjeçi luftoi dhe u vra brigejeve të lumit Vjosë, në Dukaj të Tepelenës një vend që digjej guri nga flakët, në atë vend që Kutbiu hidhej mbi llogoren e armikut mes flakësh dhe aty ngeli i goditur për të ngelur njësh i trupëzuar me larinë e Atdheut. Por të dhënat janë shumë të pakta, edhe pse ish-partizanët kanë treguar për trimërinë e tij dhe për betejën e bërë sipër lumit Vjosa në Dukaj të Tepelenës, më 25 korrik 1944, në një datë me Mitro Xhanin, i cili kishte qenë edhe komisar i çetës së tij “Çerçiz Topulli” në një nga luftimet më të përgjakshme të batalionit të dytë të Brigadës VI Sulmuese. Më 25 korrik, në orën 4.00 të mëngjesit, u dëgjua plasja e një bombe dhe zëri i zëvendës komisarit të batalionit II Mitro Xhanit: “Para partizanë!”. Zjarr nga të katër anët dhe armët armike qëllonin pa pushim. Zjarr e flakë u ndez vendi për 3 orë rresht në luftë trup më trup me armikun. Skuadra sulmuese luftonte në vijën e parë të zjarrit. Partizani Apostol Çuni afrohet te kodra shkëmbore, hodhi 2 granata, asgjësoi një mitraloz të rëndë gjerman, por mbeti i vrarë. Skuadra sulmuese ku bënte pjesë edhe Kutbi Gjeçi u afrohet llogoreve të armikut dhe vazhdon luftime të ashpra. Mitro Xhani, mbasi kontrollon prezencën e gjithë skuadrës, urdhëroi furnizimin e saj me granata dore dhe të përgatitshin deri në luftim trup me trup. Skuadra hidhet në sulm dhe ai i pari hidhet në sulm mbi llogore, i shkatërron ato, por një plumb e merr në ballë. Ra heroikisht “Balena”. Lufta u ndez e rreptë. Në këtë kohë mbërrijnë edhe partizanët e tjerë të batalionit, të cilët në bashkëveprim me forcat territoriale e shpartallojnë armikun. Bilanci i kësaj lufte ishin shumë të vrarë nga forcat armike, 70 robër, 5 mitraloza të rëndë të zënë trofe, 6 të lehta, 160 pushkë etj. Batalioni gjerman u shpartallua përfundimisht, por nga forcat partizane mbetën përjetësisht në altarin e lirisë 11 partizanë: Kutbi Çelo Gjeçi (25.2.1924 -25.7.1944, rënë në oborrin e shkollës në Dukaj), nga Fushëbardha e Gjirokastrës; Mitro Gogo Xhani (1916-15.4.1944) nga Piqerasi i Sarandës; Apostol Leonidha Çuni (1919-25.7.1944) nga Piqerasi Sarandë; Avdul Demir Demiraj (1923-25.7.1944) Kallarati Vlorë; Rushan Murat Goxho Nivicë Tepelenë (1921-25.7.1944); Koço Gligor Koçollari (4.4.1924-25.7.1944) Gjirokastrë (në qytet); Jorgo Jovan Andoni (1924-25.7.1944) Kudhës Himarë; Mërtiko Miço Velça (1924-25.7.1944) Kudhës Vlorë; Barxho Asqeri Abazaj (5.5.1920-25.7.2025) Progonat Tepelenë; Ismail Xhemali Cacaj (5.3.1920 -25.7.1944), Toskmaraloz Tepelenë; Bilal Rremkë Tushi (1906 -25.7.1944, Vërmik Vlorë).

Çlirimi i Dukajt u la me gjakun e Kutbi Gjeçit, Mitro Xhanit dhe gjithë dëshmorëve të tjerë dhe të partizanëve të plagosur. Partizanët luftuan trimërisht dhe nuk i bënë dredha plumbit. Luftuan trimërisht, ndërsa fitorja e kësaj beteje shënoi datën e çlirimit të fshatit Dukaj, më 25.7.1944. Në vitet që pasuan, 25 korriku do të kthehej në festë popullore dhe dëshmorët do të përkujtoheshin dhe përkujtohen gjithmonë në Dukaj. Kutbi Çelo Gjeçi është i shpallur “Dëshmor i Atdheut” me Vendim nr.65 datë 2.10.1971 të ish-Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit Gjirokastrë; ndërsa eshtrat e tij prehen në varrezat e dëshmorëve të Gjirokastrës.

Kutbi Gjeçi erdhi në jetë në Fushëbardhën e trimërisë, lavdisë dhe mençurisë, jetoj pak dhe mbeti në histori, duke trashëguar vetitë më të mira të Labërisë, mësoi që në vegjëli artin e të luftuarit të trashëguar shekujve nga çdo trevë shqiptare, por ngeli përjetësisht në altarin e lirisë si një prej dëshmorëve të shquar të LANÇ-it.

Burime studimi: Resul Bedo, seria e librave Yje të Pashuar, Vëll VII, Tiranë, 1999, faqe 23-25., 103-104 (Kutbi Gjeçi); Grusht çelik Brigadë e gjashtë, Tiranë, 1979, Sevo Tarifa, 912 shqiponja partizane formuan BrVIS, Gazeta telegraf.al. publikuar më 24.1.2014.; Fero Golemi, Nga Fushëbardha në Ushtrinë Popullore, Tiranë, 2015.; Gojëdhëna për luftën e luftëtarëve të BrVIS janë marrë nga ish-bashkëluftëtarët e dëshmorit: Mit’hat Baho, Sevo Tarifa, Resul Bedo; Të dhëna nga arkivi familjar I oxhakut “Gjeçi”, Shkrime të ish-luftëtarëve të BrVIS, Periodiku i gazetës së SHKA “Fushëbardha (2003-2020), që gjendet në Bibliotekën Kombëtare.



Kolonel (P) Astrit Xhakolli

Shkolla Ushtarake “Skënderbej” është cilësuar si fidanishte e ushtrisë. Është fakt që janë me qindra nxënësit e kësaj shkolle që në udhët e jetës, janë integruar me dinjitet në shoqëri, duke arritur në funksione të larta shtetërore si deputetë, ministra e presidentë, por që kanë shkëlqyer e shkëlqejnë njëkohësisht në fushat e shkencës, në diplomaci, në sporte e në fushën e artit.

Kjo shkollë, nuk ishte vetëm institucioni i pazëvendësueshëm bazë që formonte kuadrot e ardhshëm të ushtrisë, por dhe një qendër e rëndësishme që ‘prodhonte’ sportistë cilësorë, që i dhanë emër ekipit “Partizani” në të gjitha sportet si edhe ekipit kombëtar. Janë me dhjetëra apo qindra ikona sportive që kanë qenë skënderbegas, duke u bërë kampionë e rekordmenë e duke e çuar më tej lavdinë e kësaj shkolle.

E kush më mirë se djemtë dhe vajzat e kësaj shkolle elitë do ta përshkruante me emocion dhe vërtetësi jetën “Skënderbegase”.

Një prej tyre është dhe ish-skënderbegasi Astrit Xhakolli, i cili sjell nga Amerika e largët, për lexuesin e shtypit ushtarak, kujtimet dhe mbresat e pasqerueshme për bashkudhëtarët e tij në rrugëtimin e bukur ushtarak.

Kujtime që na bënë krenarë

Përgatitja fizike ishte që nga dita e parë e krijimit të saj, pjesë e pandarë e formimit intelektual e profesional të nxënësve të shkollës ‘Skënderbej’.

Këtij qëllimi i shërbyen jo vetëm veprimtaritë e larmishme sportive, garat, kampionatet, spartakiadat, stërvitjet, fushimet dimërore e verore, marshimet... Por sidomos krijimi i ekupeve të mirëfillta sportive, si ato të atletikës, boksit, mundjes, basketbollit e volejbollit, e patjetër të futbollit, ishte një shtysë dhe ëndërr e atyre djelmohave për të arritur rezultate të larta në përgatitjen fizike e pse jo, për t’u bërë pjesë e ekipit lavdiplotë të “Partizanit”.

Një ëndërr që me dhjetëra e qindra skënderbegas e realizuan. Legjendat dhe kampionët e mëdhenj të Partizanit, si Petrit Murzaku e Petrit Caslli, Suvorov Nikolla, Abedin Lame, Ndoc Ndoci, Isa Tare, vëllezërit Ndue e Skënder Doda, Besnik Satka, Kastriot Mushi, Avenir Kalaja etj., për të vajtur te emrat e mëdhenj të futbollit, Bashkim Myhedini, Gjergj Thaka, Neptun Bajko, Torez Çiraku, Agim Murati, Perlat Musta, Arian Ahmetaj e sa të tjerë, që u rritën me emrin e bukur skënderbegas, ishin edhe një frymëzim e motivim për breza të tërë sportistësh. Por ata u bënë motiv që jo vetëm të synonin ekipin e “Partizanit”, por që edhe ekipet e Shkollës të ishin ndër më të mirët në gara e veprimtari në rang Ushtrie, por edhe mes shkollave të mesme të Tiranës e gjithë Shqipërisë. Megjithatë, deri në vitin 1972 Shkolla nuk kish marrë asnjëherë Flamurin e Spartakiadave në shkallë Ushtrie, e për këtë pengesë ishte bërë ekipi i futbollit, edhe pse në radhët e tij ishin disa futbollistë të “Partizanit”. Duhet thënë se në ekipet e Korpuseve (njësi ushtarake që u shkrinë në vitin 1983), luanin lojtarët e ekupeve të rretheve ku ishin dislokuar, edhe ata të ekipit kombëtar. Komanda e Shkollës ishte besimplotë se në Spartakiadën e vitit 1973, atë të 30 vjetorit të krijimit të Ushtrisë, ekipi i futbollit do të ishte kampion! Trajnerëve të ekipit, të mirënjohurit Iljaz Dingu dhe Sherif Çiçiku u ra një barrë e madhe, ata ishin nën presion jo vetëm nga eprorët, por edhe nga mbi dymijë e ca tifozët e zjarrtë, d.m.th. skënderbegasit dhe prindërit, vëllezërit e motrat e tyre, por edhe dashamirësve të shumtë të “begsave”!

Në 12 ndeshjet eliminatorë, ekipi ynë nuk humbi asnjë, barazoi vetëm një me ekipin e Mbrojtjes Kundërajrore dhe ndeshjet e tjera i fitoi 1:0 e 2:0.

Dhe ja, në finale! Stadiumi “Dinamo”, - sot “Selman Stërmasi”,



KUR NE SKËNDERBEGASIT FITONIM KUPËN E PARË NË FUTBOLL



NJË ËNDËRR QË ME DHJETËRA E QINDRA SKËNDERBEGAS E REALIZUAN. LEGJENDAT DHE KAMPIONËT E MËDHENJ TË PARTIZANIT, SI PETRIT MURZAKU E PETRIT CASLLI, SUVOROV NIKOLLA, ABEDIN LAME, NDOC NDOCI, ISA TARE, VËLLEZËRIT NDUË E SKËNDER DODA, BESNIK SATKA, KASTRIOT MUSHI, AVENIR KALAJA ETJ., PËR TË VAJTUR TE EMRAT E MËDHENJ TË FUTBOLLIT, BASHKIM MYHEDINI, GJERGJ THAKA, NEPTUN BAJKO, TOREZ ÇIRAKU, AGIM MURATI, PERLAT MUSTA, ARIAN AHMETAJ E SA TË TJERË, QË U RRI TËN ME EMRIN E BUKUR SKËNDERBEGAS, ISHIN EDHE NJË FRYMËZIM E MOTIVIM PËR BREZA TË TËRË SPORTISTËSH.

- ishte plot! Dukej si një festë e vërtetë sportive, ku skënderbegasit ishin më të zjarrtët, më të zhurmshtmit, më të paduruarit! Ekipi i tyre do të ndeshje me “Rozafën” e Korpusit të Shkodrës, në të vërtetë me “Vllazninë”, pasi gjysma e tyre a më shumë luanin për të a për të rinjtë. I kam para syve shokët e mi të skuadrës. Astrit Xhakolli dhe Artur Lekbello ishin portierë, kapiten ishte Agim Bedinin, e më tej skuadra vazhdonte me Arian Shoren, Ylli Pulajn, Ilir Dostin, Fatmir Gjatën, Luanin Bonin, Demokrat Anastasin, Luftar Gurin, Roland Naston, Çimin, Tikun, Petritin...

Në dhomën e zhveshjes vendosmëria, besimi, por edhe tensioni ishin në kulm. Profesor Iljazi dhe i apasionuari Sherif Çiçiku jepnin këshillat e fundit, dhe mundoheshin të fshihnin edhe ata emocionet. Na kujtuan ç’na thanë Komandanti i Shkollës Meço Starja dhe Komisari, Agim Tepelena, para se të niseshim. Edhe ne i kishim në vesh porositë e tyre. “Tek ju djem, - tha Komandanti, - shoh shpirtin e fitores. Më kujtoni vetëm time dhe të shokëve të mi partizanë, kur kaq sa ju, hynim në betejë me kundërshtarë ushtarët e një ushtrie

shumë më të përgatitur. Dhe dolëm fitimtarë se kishim besim në fitore dhe mbështetëm njëri - tjetrin.

Fitorja e Flamurit të Spartakiadës është në dorën tuaj - tha Komisar Agimi. Ekipet e tjera e bënë detyrën, sytë dhe shpresa tani janë mbi ju! Dhe ne ja dolëm! Dy golat e Luftarit dhe Luanit mjaftuan për kurorën e kampionit! Ishte fantastike të fitoje e të ishe kampion, por edhe më fantastike ishte gëzimi dhe entuziazmi i shokëve tanë, i një shkolle të tërë! E dinim që kundërshtarët ishin më cilësorë, me më shumë përvojë se ne. Por asnjë skuadër nuk kishte shpirtin luftarak dhe entuziazmin rinor e besimin në fitore siç e kishim ne! Ne përfaqësonim shkollën “SKËNDERBEJ” dhe kjo na jepte forcë e besim.

Kur udhëtonim nga Stadiumi për në Shkollë e dinim si do të priteshim, por ishim edhe krenarë kur t’i dinim përpara Komandantit e Komisarit, dikur partizanë fitimtarë, sepse dhe ishim fitimtarë, kishim bërë më të mirën për lavdinë dhe nderin e Shkollës me atë emër aq të madh e të lavdishëm!

GËZUAR PAVARËSINË E SHTRENJTA KOSOVË!

17 shkurti 2008, shënon shpalljen e pavarësisë së Kosovës, një moment historik për shqiptarët e Kosovës pas një konflikti të gjatë me Serbinë.

Shpallja e Pavarësisë së Kosovës është bërë, më 17 shkurt të vitit 2008, në orën 15:39 minuta, në Kuvendin e Republikës së Kosovës në Prishtinë. Në një mbledhje të jashtëzakonshme, ku merrnin pjesë 109 nga gjithsej 120 deputetë, Kuvendi i Kosovës njëzëri shpalli Kosovën shtet të pavarur, sovran dhe demokratik.

Për të kuptuar se si lindi ky konflikt dhe si u përshkallëzua, duhet të kthehemi pas në histori.

1. Rrënjët e Konfliktit

Periodha Osmane dhe Ndikimi Serb: Kosova ishte pjesë e Perandorisë Osmane për disa shekuj. Pas Luftërave Ballkanike (1912-1913), ajo u aneksua nga Serbia, duke çuar në shtypjen e shqiptarëve etnikë, të cilët përbënin shumicën e popullsisë.

Jugosllavia dhe Statusi i Kosovës: Pas Luftës së Dytë Botërore, Kosova u bë pjesë e Jugosllavisë socialiste, duke gëzuar njëfarë autonomie brenda Republikës së Serbisë. Megjithatë, shqiptarët vazhdonin të diskriminoheshin dhe kërkesat e tyre për të drejta më të mëdha nuk u plotësuan.

2. Përshkallëzimi i Konfliktit (1980-1999)

Heqja e Autonomisë (1989): Në vitin 1989, Slllobodan Millosheviçi hoqi autonominë e Kosovës dhe vendosi një regjim represiv ndaj shqiptarëve, duke shkaktuar protesta masive.

Lëvizja Paqësore e Rugovës (1990-1997): Udhëheqësi politik Ibrahim Rugova udhëhoqi një rezistencë paqësore, duke shpallur një shtet paralel shqiptar në Kosovë. Megjithatë, Serbia e injoroi këtë lëvizje.

Formimi i UÇK-së (1997-1998): Për shkak të dhunës serbe dhe mungesës së rezultateve nga diplomacia, u krijua Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) për të luftuar për pavarësinë me armë. Konflikti u përshkallëzua me luftime të ashpra mes UÇK-së dhe forcave serbe.

3. Lufta e Kosovës dhe Ndërhyrja e NATO-s (1998-1999)

Masakrat dhe Spastrimi Etnik: Serbia nisi një fushatë të egër spastrimi etnik, duke vrarë dhe dëbuar qindra-mijëra shqiptarë. Masakra e Reçakut (janar 1999) tronditi botën dhe tërhoqi vëmendjen e ndërkombëtarëve.

Administrimi i OKB-së dhe Pavarësia: Pas luftës, Kosova u administrua nga OKB-ja (UNMIK), ndërsa shqiptarët kërkonin pavarësinë. Pas bisedimeve të dështuara me Serbinë, Kosova shpalli pavarësinë, më 17 shkurt 2008.

Më 9 korrik 1998, Presidenti i SHBA-ve, Bill Clinton deklaroi “emergjencën kombëtare”, (gjendje e jashtëzakonshme) për shkak të “kërcënimit të pazakontë dhe të jashtëzakonshëm të sigurisë kombëtare dhe politikave ndërkombëtare të Shteteve të Bashkuara”, imponuar nga Jugosllavia dhe Serbia mbi Luftën e Kosovës.

Më 23 shtator 1998, nën Kapitullin VII të Kartës së OKB-së, Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara pranoi Rezolutën 1199. Kjo shprehte një ‘shqetësim të madh’, me raportet që i arrinin Sekretarit të Përgjithshëm që mbi 230,000 njerëz janë dëbuar nga shtëpitë e tyre nga ‘përdorimi i forcës së tepërt dhe diskriminues nga forcat e sigurisë serbe dhe Ushtria Jugosllave’, duke kërkuar që të gjitha palët në Kosovë dhe në Republikën Federale të Jugosllavisë Serbia dhe Mali i Zi të ndalojnë armiqësinë dhe të mbajnë një armëpushim.

Më 24 shtator, Këshilli i Atlantikut të Veriut (NAC) i NATO-s lëshoi një “paralajmërim aktivizimi” (ACTWARN), duke e çuar NATO-n në një nivel më të lartë gatishmërie ushtarake si për një mundësi të limituar ajrore ashtu edhe për një fushatë ajrore me faza në Kosovë. Problemi i madh për ata që shihnin si zgjidhjen e vetme përdorimin e forcës ishin mbi 250,000 shqiptarë të dëbuar, 30,000 prej të cilëve ishin në qiej të hapur në pyje, pa veshmbathje apo strehim, dhe me dimrin që afrohej shpejt. Ndërkohë, ambasadori amerikan në Republikën e Maqedonisë, Christopher Hill, po drejtonte diplomacinë ndërmjet delegacionit shqiptar, i drejtuar nga Rugova, dhe autoritetet jugosllave dhe serbe.

Në këto mbledhje po bëhej një plan paqeje pas planifikimit të NATO-s për pushtimin e Kosovës. Gjatë një periudhe prej dy javësh, kërcënimet u shtuan, duke kulmuar në dhënien nga NATO të Urdhrit të Aktivizimit. NATO ishte gati të fillonte sulmet ajrore, dhe Richard Holbrooke shkoi në Beograd me shpresën se do të arrinte një marrëveshje me Millosheviçin. Zyrtarisht, komuniteti ndërkombëtar kërkoj të ndaloheshin luftimet. Specifikisht kërkohet që Jugosllavia të pushonte ofensivën ndaj UÇK-së ndërkohë që përpieq që të bindte UÇK-në të heqë dorë nga pavarësia. Në tepër, u bëjnë përpjekje për të bindur Millosheviçin të lejonte trupat paqeruajtëse të NATO-s të hynin në Kosovë. Më 13 tetor 1998, Këshilli i Atlantikut të Veriut lëshoi urdhrat e aktivizimit (ACTORD) për ekzekutimin e sulmeve të limituara ajrore, po ashtu edhe fushatë ajrore me faza në Jugosllavi, e cila do të fillonte përafërsisht për 96 orë. Më 15 tetor, Marrëveshja e Misionit të Verifikimit në Kosovë (KVM) i NATO-s për armëpushim u firmos, dhe afati i fundit për tërheqjen u zgjat për më 27 tetor. Tërheqja serbe filloi më, ose rreth 25 tetorit 1998, dhe Operacioni Syri i Shqiponjës (Eagle Eye) filloi më 30 tetor.

KVM ishte një kontingjent i madh i monitoruesve të paarmatosur të paqes nga OSBE (të njohur zyrtarisht si verifikues), të cilët u futën në Kosovë. Pamjaftueshmëria e tyre ishte e dukshme që në fillim. Ata u quajtën me nofkën “clockwork oranges” (me kuptimin në zhargon anglisht si diçka e pavend dhe të panevojshme) si referencë për makinat me ngjyrë portokalli që përdornin. Luftimet filluan sërish në dhjetor 1998, pasi armëpushimi u thye, dhe gjatë luftimeve u vra Zvonko Bojanić, kryebashkiaku serb i Fushë-Kosovës. Autoritetet jugosllave u përgjigjën me masa të ashpra ndaj ushtarëve të UÇK-së. Nga janari në mars 1999, lufta solli pasiguri në zonat urbane, duke përfshirë bombardime dhe vrasje. Të tilla sulme u kryen edhe gjatë



bisedimeve në Rambuje në shkurt dhe ndërkohë që Marrëveshja e Verifikimit në Kosovë u zgjidh në mars.

Më 15 janar 1999, ndodhi Masakra e Reçakut ku 45 fermerë shqiptarë u rrethuan, u drejtuan drejt një kodre dhe u masakruan. Trupat u zbuluan nga monitoruesit e OSBE-së, duke përfshirë edhe Kryetarin e Misionit William Walker, dhe të dërguarit e huaj të shtypit ndërkombëtar. Jugosllavia e mohoi masakrën. Masakra e Reçakut ishte kulmimi i sulmeve të UÇK-së dhe reprezaljes së jugosllavëve që vazhduan përgjatë gjithë dimrit 1998–1999. Masakra u ndëshkua nga vendet perëndimore dhe nga Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, dhe më vonë u bë baza e një prej akuzave për krime lufte ndaj Millosheviçit dhe zyrtarëve të tij më të lartë. Kjo masakër ishte një pikë kthese e luftës.

NATO vendosi se konflikti mund të zgjidhej vetëm duke vendosur një mision paqeruajtës ushtarak nën komandën e NATO-s. Prishtina u bë subjekt i përlëshjeve me armë dhe dëbimit të popullsisë sipas raporteve të OSBE-së.

Humbjet civile

Në qershor të vitit 2000, Kryqi i Kuq raportoi për 3,368 civilë (2,500 shqiptarë, 400 serbë, dhe 100 romë) ende të humbur, afërsisht një vit pas konfliktit.

Një studim i kërkuesve të Center for Disease Control and Prevention (Qendra e Kontrollit dhe Parandalimit të Sëmundjeve) në Atlanta, Gjeorgjia, publikoi në vitin 2000 në një gazetë mjekësore “The Lancet” se ka pasur rreth “12,000 të vdekur në të gjithë popullsinë”, të cilat kanë si shkak luftën. Ky numër u arrit gjatë vëzhgimit të 1,197 shtëpive nga shkurti 1998 deri në qershor 1999. 67 nga 105 vdekje të raportuara në popullsinë e përgjithshme kishin si shkak trauma të shkaktuara nga lufta, nga kjo del shifra e 12,000 të vdekurve nëse zbatohet kjo shkallë vdekshmërie në të gjithë popullsinë e Kosovës. Shkalla më e lartë e vdekshmërisë ishte te meshkujt nga 15 deri 49 vjeç (5,421 viktima të luftës) si edhe për meshkujt mbi 50 vjeç (5,176 viktima). Për personat nën 15, përafërsisht 160 viktima për meshkujt dhe 200 për femrat. Për femrat nga 15–49 vjeç rreth 510 viktima; më të mëdha se 50 vjeç rreth 541 viktima.

Autorët gjithashtu shkruajnë se nuk mund të ndahen humbjet civile nga ato ushtarake, pasi u kryen shumë vrasje ndaj njerëzve të paarmatosur.

Në një studim të vitit 2008 nga Humanitarian Law Center (Qendra Ligjore Humanitare), Komisionit Ndërkombëtar të Njerëzve të Humbur, dhe Komisionit të Njerëzve të Humbur të Serbisë bënë një listë emër për emër për viktimat gjatë dhe pas luftës.

Sipas Librit të Kujtimit të Kosovës, 13,421 njerëz u vranë në Kosovë gjatë konfliktit, nga 1 janari 1998 deri në dhjetor 2000. Nga ajo shifër, 10,533 ishin shqiptarë, 2,238 serbë, 126 romë, 100 boshnjakë dhe të tjerë.

Krimet e luftës nga serbët

Qeveria e Serbisë ka bërë shumë pak për t’u përballur me serbët e akuzuar për krime lufte; bashkëpunimi me Gjykatën Ndërkombëtare Kriminale për ish-Jugosllavinë ende “quhet si detyrim stresues, çmim i nevojshëm për t’u futur në Bashkimin Europian”.

Presidenti Jugosllav Slllobodan Millosheviç, së bashku me Milan Milutinović, Nikola Šainović, Dragoljub Ojdanić dhe Vljako Stojiljković u akuzuan nga ICTY për krime kundër njerëzimit dhe duke përfshirë vrasje, zhvendosje me forcë, deportim, dhe “persekutim për shkaqe politike, raciale dhe fetare”. Në 2001, Presidenti Vojsllav Koshtunica “luftoi me dhëmbë e me thonj” kundër përpjekjeve për të vënë Millosheviçin para një gjykate ndërkombëtare, por nuk mundi ta parandalonte këtë gjë pas daljes në skenë të provave të tmerrshme të luftës. Në tetor 2003, u shtuan akuzat për ish-shefin e shtabit të forcave të armatosura Nebojša Pavković, ish-komandantin e trupave të ushtrisë Vladimir Lazarević, ish-oficerin e policisë Vlastimir Đorđević, dhe Sreten Lukić.

Të gjithë u akuzuan për krime kundër njerëzimit dhe thyerje të ligjeve dhe rregullave të luftës. Më vonë, Gjykata Ndërkombëtare Kriminale për ish-Jugosllavinë e OKB-së (ICTY) zbuloi ligjërisht se Serbia “përdor(i) dhunën dhe terrorin për të larguar me forcë shqiptarët e Kosovës nga shtëpitë e tyre përtej kufirit, në mënyrë që autoritet të merrnin kontrollin mbi Kosovën... Kjo fushatë u drejtua nga Ushtria dhe forcat policore (MUP) të Ministrisë së Brendshme nën kontrollin e RFJ dhe autoriteteve serbe, të cilat ishin përgjegjëse për dëbimet masive të civilëve shqiptarë nga shtëpitë e tyre, po ashtu edhe incidentet vrasjesh, sulme seksuale, dhe shkatërrimit me dëshirë të xhamive.

Sot Kosova gëzon “hisen e diellit” që i takon. Edhe pse vrugat e dhimbjes ende pikojnë gjak, vëllezërit tanë po punojnë për të vënë në vend amanetin e Bac Ademit. “Bac u Kry, Kosova është e lirë”!

Zemra e çdo shqiptari, të cilësdo krahinë, rreh brenda shqiponjës dykrenore dhe gjakut të sakrificave shekullore që e përskuq plot dinjitet. E shtrenjta Dardani, e populluar me trima, qytetarë të talentuar, të mençur e plot vullnet, jam e bindur që kombi ynë do shohë ditë të mrekullueshme, ku të gjithë bashkë, pa kufij dhe ndasi, do punojmë e do t’i shërbejmë atdheut tonë me gjithë dashurinë që ky vend i bekuar nga Zoti meriton!

Gëzuar Pavarësinë e shtrenjta Kosovë!

Armët nuk janë problemi kryesor, mentaliteti i njerëzve që i përdorin për të bërë dëm, është ai që duhet ndryshuar

Teknologjia ushtarake ka pasur një ndikim të madh në historinë e njerëzimit, jo vetëm në fushën e betejës, por edhe në jetën paqësore. Zhvillimet në armatime dhe strategji ushtarake kanë sjellë ndryshime të rëndësishme në ekonomi, shkencë, mjekësi dhe teknologji civile. Interneti, që sot është jetik për komunikimin dhe biznesin, fillimisht u zhvillua si një projekt ushtarak (ARPANET). GPS (Sistemi i Pozicionimit Global), i cili sot përdoret për navigim në telefona dhe makina, fillimisht u krijua për ushtrinë amerikane, ndërsa dronët nga përdorimi ushtarak, tani përdoren për fotografi, mbikëqyrje bujqësore dhe dërgimin e mallrave.

Ndërsa teknikat e shpëtimit të jetës, si transfuzionet e gjakut dhe reanimimi kardiopulmonar (CPR), u zhvilluan për të ndihmuar ushtarët në luftë dhe tani përdoren në spitale në mbarë botën. Përparimet në aeronautikë gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe Luftës së Ftohtë ndihmuan në krijimin e avionëve komercialë që sot përdoren për transportin global. Energjia Bërthamore; Fillimisht e zhvilluar për qëllime ushtarake, tani përdoret për prodhimin e energjisë elektrike në shumë vende të botës. Materiale të Reja: Fibra të forta, çeliku i lehtë dhe plastikë të avancuara u zhvilluan për pajisje ushtarake, por tani përdoren në ndërtim, makineri dhe produkte të përditshme. Teknologjitë e përdorura për zbulimin e armikut tani ndihmojnë në sigurinë publike, si kamerat inteligjente dhe skanerët e sigurisë në aeroporte. Ushtria ka zhvilluar teknologji për mbrojtjen nga sulmet kibernetike, që tani përdoren nga bankat dhe qeveritë për të mbrojtur të dhënat e ndjeshme.

Teknologjia ushtarake ka qenë një katalizator i rëndësishëm për zhvillimin e botës moderne. Ndërsa synimi i saj fillestar ka qenë për qëllime mbrojtjeje dhe luftimi, shpikjet e bëra në këtë fushë kanë sjellë përfitime të mëdha për shoqërinë në kohë paqeje. Në të njëjtën kohë, vazhdon të ketë debate mbi ndikimin e saj etik dhe rrezikun e keqpërdorimit të teknologjive të avancuara.

Dy anët e ndikimit të teknologjisë

Zhvillimi i teknologjisë ushtarake ka dy anë, njëra që çon përpara inovacionin dhe përmirëson jetën, dhe tjetra që mund të krijojë kërcënime të reja për shoqërinë. Teknologjitë e avancuara ushtarake, veçanërisht armët bërthamore, kimike dhe biologjike, mund të shkaktojnë shkatërrim masiv nëse nuk rregullohen me kujdes.

Marrëveshjet ndërkombëtare si Traktati për Mosshpërndarjen e Armëve Bërthamore (NPT) dhe Konventa e Armëve Kimike janë shembuj të përpjekjeve për të kufizuar këto rreziqe, por duhen rregulla më të forta dhe zbatim më i mirë.

A duhet kufizimi i Përdorimit

të Inteligjencës Artificiale në Luftë?

Armët autonome që përdorin inteligjencën artificiale mund të marrin vendime pa ndërhyrje njerëzore, duke shkaktuar viktime civile dhe duke e bërë luftën më të paparashikueshme. Ndaj, organizata të ndryshme kërkojnë ndalimin e “robotëve vrasës”, por disa shtete po zhvillojnë këto teknologji pa rregulla të qarta.

Sulmet kibernetike mund të përdoren për të sabotuar rrjete energjetike, banka dhe sisteme qeveritare, duke shkaktuar kaos pa nevojën e armëve tradicionale.

Teknologjitë ushtarake të mbikëqyrjes, si kamerat inteligjente dhe njohja e fytyrës, po përdoren gjithnjë e më shumë nga qeveritë për të kontrolluar qytetarët, shpesh duke shkelur të drejtat e njeriut. Pa rregulla më të rrepta, teknologjia ushtarake mund të bëhet një kërcënim i madh për sigurinë globale dhe të drejtat e njeriut. Ndërsa inovacioni është i pashmangshëm, është e rëndësishme që zhvillimi dhe përdorimi i armëve të avancuara të ndjekë parime etike dhe të jetë i kontrolluar nga ligje ndërkombëtare.

Rivaliteti Global

Shtetet e fuqishme, si SHBA, Kina dhe Rusia, investojnë miliarda dollarë në zhvillimin e armëve të reja dhe inteligjencës artificiale ushtarake për të ruajtur dominimin e tyre.

Nëse një vend pranon kufizime, por rivalët e tij nuk e bëjnë, ai mund të ndjehet i pambrojtur dhe të refuzojë marrëveshje të reja.

Ka pasur disa marrëveshje të suksesshme, si Traktati i Mosshpërhapjes Bërthamore (NPT) dhe Traktati START për



reduktimin e armëve bërthamore, por shpesh këto traktate u janë shmangur ose janë anuluar nga fuqitë e mëdha kur nuk u ka interesuar më.

Armët e Shkatërrimit në Masë

Armët bërthamore mbeten një kërcënim madhor, sidomos me tensionet e rritura midis fuqive botërore. Armët biologjike dhe kimike mund të përdoren për të shkaktuar pandemi artificiale ose dëme të parikuperueshme në popullatë. Përhapja e inteligjencës artificiale në fushën ushtarake po krijon mundësi për zhvillimin e armëve autonome vdekjeprurëse.

Si mund të mbrohet njerëzimi?

- Forcimi i sigurisë kibernetike përmes investimeve në mbrojtje digjitale dhe edukimin e qytetarëve.
- Diplomacia dhe marrëveshjet ndërkombëtare për të kufizuar përdorimin e armëve të shkatërrimit në masë.
- Zhvillimi i teknologjive të mbrojtjes për të parandaluar sulmet dhe për të zvogëluar efektet e tyre.
- Bashkëpunimi global dhe ndërgjegjësimi janë kyç për të shmangur një katastrofë të mundshme nga këto kërcënime.

Koncepti i armëve luftarake për mbrojtjen e jetës së humanëve është një debat i rëndësishëm në fushën e sigurisë dhe etikës ushtarake. Në teori, armët duhet të shërbejnë për parandalim, vetëmbrojtje dhe ruajtjen e paqes, por historia ka treguar se shpesh ato përdoren edhe për agresion dhe pushtim.

Si mund të përdoren armët

për mbrojtje dhe jo për shkatërrim?

Sistemet e mbrojtjes ajrore (si Iron Dome në Izrael apo Patriot Missiles në SHBA) përdoren për të shkatërruar raketat armike para se të godasin objektivat e tyre. Dronët mbrojtës dhe robotika mund të përdoren për zbulim, shpëtim dhe mbrojtje, në vend të sulmeve vdekjeprurëse. Sistemet e luftës elektronike mund të bllokojnë sulmet kibernetike, komunikimin armik dhe përdorimin e dronëve sulmues pa pasur nevojë për dhunë të drejtpërdrejtë.

Pajisjet elektrohokuese (Tasers) dhe armët sonike përdoren për neutralizimin e kërcënimeve pa shkaktuar vdekje. Armët me energji drejtuar (si lazerët jodëmtues) mund të çaktivizojnë objektiva pa dëmtuar jetë njerëzore. Mjetet për shpërndarjen e turmave, si gazrat lotsjellës dhe topat e ujit, përdoren për kontrollin e trazirave

pa shkaktuar humbje jete.

Edhe armët “mbrojtëse” mund të keqpërdoren për agresion ose shtypje.

Përdorimi i armëve jo-vdekjeprurëse në duar të gabuara mund të shkaktojë abuzim të të drejtave të njeriut. Rregullimi ndërkombëtar dhe marrëveshjet për kontrollin e armëve janë të domosdoshme për të siguruar që teknologjitë e reja të përdoren për mbrojtje dhe jo për shkatërrim.

Nëse njerëzimi fokusohet më shumë në armët mbrojtëse dhe teknologjitë e paqes, do të mund të ndërtohet një botë më e sigurt pa nevojën për konflikte të përgjakshme.

Si do të ishte një botë pa armë?

Paqe dhe Siguri më e Madhe. Më pak luftëra dhe konflikte të përgjakshme. Pa armë, shtetet nuk do të kishin mjete për të zhvilluar luftëra tradicionale.

Kriminalitet më i ulët. Nëse armët e zjarrit dhe armët e tjera të rrezikshme nuk ekzistojnë, dhuna në rrugë dhe vrasjet do të uleshin ndjeshëm.

Fokus më i madh në diplomaci dhe bashkëpunim. Në mungesë të armëve, vendet dhe individët do të ishin të detyruar të gjejnë zgjidhje paqësore për konfliktet.

A mund të ndodhë kjo?! Si? Skeptike....

Në historinë e njerëzimit, armët kanë ekzistuar që nga shpikja e shigjetës dhe heshtës, duke evoluar në shpatat, armët e zjarrit dhe armët bërthamore. Për të arritur një botë pa armë, do të nevojitej: Marrëveshje ndërkombëtare të forta për çarmatosje totale. Ndryshim i mentalitetit njerëzor, ku agresioni nuk shfaqet më si zgjidhje e konflikteve.

Sisteme të fuqishme të drejtësisë dhe sigurisë, që të mos lejojnë krimin dhe abuzimin me pushtetin.

A ka shpresë për një botë më paqësore?

Edhe pse një botë pa armë është pothuajse e pamundur në realitet, njerëzimi mund të punojë për një botë me më pak armë, duke promovuar: Reduktimin e armëve bërthamore dhe luftarake përmes traktateve ndërkombëtare. Zhvillimin e armëve mbrojtëse dhe jo-vdekjeprurëse. Diplomacinë dhe edukimin e brezave të rinj për të shmangur konfliktet me dhunë.

Në fund, armët nuk janë problemi kryesor, mentaliteti i njerëzve që i përdorin për të bërë dëm është ai që duhet ndryshuar.



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Skënder Teki Libohova lindi në qytetin e Lushnjës, më 2 qershor 1920, nga një familje patriotësh. Fëmijërinë e kaloi në Myzeqe, ku mbaroi filloren në Lushnje dhe më 1935 shkoi në Normalen e Elbasanit. Pas shkollës Normale, vijoi studimet në Tregtaren e Vlorës. Këtu, Skënderi 18-vjeçar nis veprimtarinë revolucionare, ku në mars 1940 përjashtohet nga Shkolla Tregtare e Vlorës, pasi kishte marrë pjesë në manifestim. Në dhjetor 1941 hyri në radhët e Rinisë Komuniste Shqiptare dhe në mars 1942 u përjashtua nga të gjitha shkollat e Shqipërisë “si element i rrezikshëm antifashist...”. Kthehet në Lushnje dhe menjëherë në maj 1942, hyn në radhët e PKSH. Celula komuniste organizoi në Lushnje demonstratën e 26 janarit 1943, që mori karakterin e një manifestimi të fuqishëm, Skënderi doli në mal, në çetën partizane të Myzeqesë. Në mars 1944 u inkuadrue në radhët e BrVIIS dhe u emërua në batalionin e parë komisar dhe kaloi në Veri, duke përshkuar gjithë zonat e Shqipërisë së Mesme. Skënderi mori pjesë në çlirimin e Mirditës, në luftimet që zgjatën tri ditë në fshatin Gëziq e në qendër të Shënpalit dhe në çlirimin e Shkodrës. Pastaj brigada kaloi përtej kufijve, në ndjekje të okupatorëve gjermanë. Më 16 dhjetor 1944, Skënderi u vra gjatë luftimeve që zhvilloi brigada në Malin e Zi, në lartësitë e Medunit të Podgoricës. Është shpallur Dëshmor i Atdheut me vendimin nr. 74, datë 25. 10. 1971 të Komitetit Ekzekutiv të KP të Rrethit të Lushnjës.

U përjetësua në këngë...

Xhemal Yzeir Hadaj lindi në Krahës të Tepelenës në vitin 1920. Në maj 1942 mobilizohet ushtar, duke u dërguar në Romë, Itali. Në shtator 1943 arratiset nga ushtria italiane dhe bie në duart e nazistëve gjermanë. Më 27.9.1943 e internojnë në Kampin e Përqendrimit në Itali. Me ndihmën e misionit ushtarak, në mars 1944 kthehet në Shqipëri. Rreshtohet partizan në BrVIIS. Lufton trimërisht deri jashtë kufijve shtetërore. Ndërsa luftonte së bashku me skuadrën partizane më 14.12.1944 bie heroikisht në Mal të Zi gjatë luftimeve me forcat gjermane. Populli e ka përjetësuar në këngën: “Nga Shqipëria, ushtar të muarr/ Në Itali të dërguan/ Në kamp të internuan/ Kur u ktheve në atdhe/ Fshatin dhe shtëpinë s’e pe/ Xhemal Hadaj, o lule”. Është shpallur Dëshmor i Atdheut me vendimin nr. 44, datë 3. 8. 1971 të Komitetit Ekzekutiv të KP të Rrethit të Tepelenës.

Ra heroikisht si trimat në ballë të luftës...

Fejzo Rakip Memaj lindi në vitin 1925, në Velçë të Vlorës. Në vatrë çdo mbrëmje mbledheshin pesë fëmijët dhe prindërit dhe kujtonin të parët e tyre, bëmat dhe luftërat. Shtëpia Memaj u kthye në një bazë të luftës. Babai i Fejzës, Rakipi, u plagos në kokë nga një copë predhë artilerie në afërsi të konakut, shtëpia e tyre u dogj nga pushtuesit, vëllai i madh Ymeri ishte partizan dhe po luftonte në Sanxhak, në BrVS, ndërsa xhaxhai i tij, Sefer Memaj kishte rënë në luftë. Djali shtatëmbëdhjetë vjeçar hodhi pushkën krahut dhe doli malit partizan në luftë kundër pushtuesve të huaj dhe tradhtarëve të vendit. Fejzo u takua me partizanët e BrIS në dhjetor 1943, që ndodhej me luftime në krahinën e Mesaplikut. Fejzua u sëmur nga të ftohtit dhe u shtrua në spitalin partizan të Zagorisë. U shërua dhe nisët për në BrVIIS. Nga 12 dhjetorit 1944 e deri më 7 shkurt 1945, brigadat BrVIS dhe BrXXIIS, së bashku me BrVIIS kryen një varg luftimeve kundër armikut për çlirimin e Vishegradit. ...Në Livarrekë, kompania ku bënte pjesë Fejzua u kacafyt trup me trup me nazistë gjermanë. Armiku u thyë duke lënë në fushë të luftimit shumë të vrarë e të plagosur dhe mjaft armatim e materiale të tjera ushtarake. Fejzua luftonte në këmbë, me mitralozin e tij dhe gjermanët po tërhiqeshin të shpartalluar. Nga një kodër përballë, një nazist shtiu me breshëri automatiku, duke e lënë trimin shtatëmbëdhjetë vjeçar të vdekur.

Është shpallur Dëshmor i Atdheut me vendimin nr. 97, datë 22. 9. 1972 të Komitetit Ekzekutiv të KP të Rrethit të Vlorës.

Për luftën ka nëna djem të tjerë...

Haziz Zenel Agushi ka lindur me 1919 Vinokash të Përmetit. ...Kur krisi pushka për liri, Hazizi u njoh me Lëvizjen Nacionalçlirimtare, u bashkua me ta dhe u rreshtua në çetën territoriale të fshatit. Në shkurt të vitit 1943 u radhit në batalionin e Dishnicës dhe më vonë në BrVIIS. Ra si trim në luftë kundër armiqve. Nënë Xhevahia kur mori vesh rënien e djalit, u tha partizanëve se “po të ketë nevojë atdheu, merreni dhe vëllanë e tij që të vazhdojë luftën që filloi Hazizi...”. Është shpallur Dëshmor i Atdheut me vendimin nr. 122, datë 11. 09. 1978 të Komitetit Ekzekutiv të KP të Rrethit të Përmetit.

Nga Skrapari ra në Vishegrad

Ibrahim Haziz Hoxha ka lindur në një familje të varfër në fshatin Gërmenj të Skraparit, më 15 prill 1930. Nuk bëri shkollë, por shkrim e lexim mësoi gjatë kohës që ishte partizan. Kur Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare kishte filluar, Ibrahim i vogël, ishte 13 vjeç. Regjistrohet vullnetar në çetën territoriale të fshatit. Në qershor 1943 Ibrahim shkoi më çetën e Mallakastrës. Në ditët e para të korrikut 1943, Ibrahim mori pjesë në luftimet kundër garnizonit të ushtrisë italiane në Përmet; kurse në tetor 1943 mori pjesë në luftimet në zonën e Tomoricës. Viti 1944 Ibrahimin e gjeti të inkuadrur në batalionin e dytë të Grupit Partizan të Skraparit. Në këtë formacion ai luftoi në Qafë-Dardhë, në Tomoricë, në Mal të Bardhë dhe në Berat, në muajin korrik të atij viti, ku u rreshtua në BrXS, por nuk u pranua se ishte i vogël. Rrugës për t’u kthyer në Skrapar, afër Beratit, takon forcat partizane të BrVIIS, u ishte lutur ta pranonin në radhët e tyre, ku përgjegjësi i rinisë dhe komanda e kompanisë te të cilët ishte paraqitur, ia plotësuan dëshirën Ibrahimit. Mori pjesë në luftën kundër autokolonave gjermane në Peqin dhe në luftimet për çlirimin e Tiranës etj. Nuk u nda brigadës edhe kur pas çlirimit të Shqipërisë ajo kaloi kufirin Verior e u shkoi në ndihmë popujve të Jugosllavisë. Ai mori pjesë në marshimet e gjata e në luftimet për çlirimin e Tuzit, në luftimet në Dumash, Kuç, Bosnje dhe së fundi

ANTIFASHISTI NGA LUSHNJA QË RA NË PODGORICË...



Ndoshta nuk e keni vënë re nëse jeni fiksuar në ciklin vjetor të iPhone-it, por përparimet teknologjike po ndikojnë në të gjitha fushat e jetës sonë - dhe kjo përfshin operacionet ushtarake. Është vendi ku shpenzohen shumat më të mëdha nga paratë e qeverive për kërkime.



Roboti BigDog (Qeni i madh)

Zhvilluar nga një kompani e quajtur "Boston Dynamics", e cila tani është në pronësi të Google, BigDog është një katërkëmbësh me pamje shumë të frikshme, që nuk do të dëshironit ta kishit pas jush nëpër pyll gjatë natës. Në fakt, nuk është krijuar për të bërë ndonjë gjueti dhe ndjekje, jo ende, gjithsesi.

Veçantia e BigDog është aftësia për të kaluar lloje të shumta terreni (rërë, borë, shkretëtirë, pyll) pa u penguar. Si rezultat, ai mund të dërgojë furnizime dhe pajisje për ushtarët në terren në vende ku helikopterët nuk mund të arrijnë, si dhe të hyjë në zona ku do të ishte e rrezikshme të dërgoheshin njerëz.



Sistemi i Armëve Laser LaWS

Marina amerikane ka përdorur LawS për pak më shumë se një vit: një top me fuqi të lartë që mund të shpërthejë varkat, dronët dhe avionët e tjerë në copëza nga një milje larg.

Ju mund ta krahasoni atë me "Death Stars" nga "Star Wars". Ai kontrollohet nga një tastierë që ngjan paksa me një tastierë lojërash, funksionon gjatë kushteve të vështira të motit dhe mund të sjellë fshirje në vetëm disa sekonda.




Armë CornerShot (me goditje nga cepi)

Fjalë për fjalë një armë që mund të gjuajë nëpër qoshe, që do të thotë se nuk do ta shihni kurrë personin që të gjuan drejt jush para se të të rrëzojnë. Duket e çuditshme dhe mund të jetë pak e vështirë për t'u mbajtur në praktikë, por kjo armë ka qenë në shërbim aktiv vitet e fundit dhe është e disponueshme në disa variacione.

Korniza e armës është fleksibël, kështu që ushtarët mund ta konfigurojnë atë që të shikojë majtas, djathtas, lart ose poshtë duke përdorur ekranin e integruar të armës: sigurisht që e bën pastrimin e dhomave dhe ndërtesave shumë më të sigurt për personin pas saj.



TEKNOLOGJI USHTARAKE e përparuar që do t'ju 'trembë' ...



Ajo mund të përdoret gjithashtu si një granatëhedhës.

Plumba vetëdrejtues

Ndërsa jemi në temën e armëve që mund të gjuajnë në qoshe, po plumbat inteligjentë që mund të ndryshojnë rrugën e tyre në ajër për të goditur objektivat e tyre, si ju duken? Sigurisht që largon presionin nga detyrimi për të synuar me saktësi, por do të thotë që keni më pak shanse nëse filloni të vraponi (ose të vozitni) në drejtim të kundërt.

Agjencia ushtarake amerikane DARPA (Agjencia e Projekteve të Kërkimit të Avancuar të Mbrojtjes) është duke u shprehur ngushtë në lidhje me teknologjinë që qëndron pas plumbave, por mendohet se një kombinim i lazerëve dhe pendëve të vogla përdoren për t'i drejtuar ata në shtëpi. Provat e suksesshme tashmë janë zhvilluar dhe këto plumba mund të kenë shërbim aktiv së shpejti.



Sistemi aktiv i mohimit

Kjo nuk vret, por sigurisht që do t'i ndjehen efektet. Sistemi i Mohimit Aktiv (ADS) mund të vendoset mbi një rezervuar, xhip ose mur rrethues, duke shpërthyer shpërthimet e drejtuara të energjisë që ngrohin lëkurën tuaj (joformalisht njihet si rrezja e nxehtësisë). Një mënyrë tjetër për të menduar për këtë është si të jeni jeni vendosur përkohësisht brenda një furre me mikrovalë dhe kjo do të pengojë shanset tuaja për të bërë një sulm ose për të kërcyer mbi muret e burgut. Me sa duket kur të ktheheni jashtë rrezes, lëkura juaj kthehet në normale.



Sistemi XM25 Counter Defilade Target Engagement (CDTE)

Ju mund të mendoni se jeni të sigurt duke u fshehur pas një muri ose brenda një ndërtese, por nuk do të jeni të sigurt kur XM25 të arrijë vitin e ardhshëm. Është një granatëhedhës me shpërthim ajror i projektuar për të gjuajtur granata me shpejtësi të lartë dhe me saktësi të veçantë - dhe falë matësit të rrezes lazer në bord, ai mund të dallojë edhe objektivat e armikut që janë të fshehura.

Është një nga armët e para 'të zgjuara' të zhvilluara nga ushtria amerikane dhe pajisjet elektronike të paketuara në armë i ndihmojnë granatat të gjejnë objektivin e tyre në mënyrë të gabuar - nëse arma duhet të bëjë rregullime për muret ose terrenin, atëherë ajo mund ta bëjë këtë. Ashtu si plumbat vetëdrejtues, ju jep shumë më pak mundësi për t'u larguar.



Drone gjurmuese me shpejtësi të lartë

Një nga dronët më të fundit autonome të DARPA-s: ato duken si lloji i lodrave që mund të keni marrë në Krishtlindje, por ato mund të anojnë automatikisht rreth pengesave dhe të arrijnë shpejtësi deri në 45 mph, që do të thotë se nuk keni shumë mundësi për të shpëtuar nga njëri prej tyre.

Tani për tani këta dronë super të shpejtë sapo po testohen, por teknologjia po bëhet gjithnjë e më e zgjuar. Agjencia po punon gjithashtu për dronët që mund të shpërndahen në ajër ose në ujë pasi të kenë përfunduar misionet e tyre dhe është e gjitha pjesë e programit "Fast Lightweight Autonomy" (FLA) që funksionon aktualisht në DARPA.

Ujërat e kristalta dhe plazhet e arta të Shqipërisë i kanë dhënë asaj titullin “Maldivet e Evropës”. Dhe është duke u bërë shpejt një nga destinacionet kryesore turistike të kontinentit me mbërritjet e vizitorëve ndërkombëtarë që rriten me 56 për qind midis 2019 dhe 2023, sipas Organizatës Botërore të Turizmit, shkruan “Daily Mail”.

Por për disa, vendi ballkanik apelon për një qëndrim më të gjatë sesa një pushim. Kostoja e ulët e jetesës po e bën atë një opcion gjithnjë e më tërheqës për pensionistët britanikë.

Jennifer Stevens, redaktore ekzekutive në “International Living”, një udhëzues për të dalë në pension dhe për të investuar jashtë vendit, thotë për “MailOnline”: “Shqipëria nuk është ende në radarin kryesor për shumë njerëz, por duhet të jetë. Është e bukur, për fillim - me një vijë bregdetare që rivalizon (shumë njerëz argumentojnë më të mirën) atë të Italisë ose Kroacisë. Dhe vlera kur bëhet fjalë për koston e jetesës është e jashtëzakonshme”.

Ndërkohë, ekipi i ekspertëve në “Magic Towns”, një udhëzues për t’u zhvendosur në Shqipëri, thotë se “merrni në pyetje banorët britanikë” pothuajse çdo ditë.

Sara Alimehmeti, redaktore në “Magic Towns”, shpjegon: “Ajo që ne gjejmë është se përzjerja e përballueshmërisë, motit të mirë dhe cilësisë së jetës, dhe normave jashtëzakonisht të ulëta të taksave, është mjaft tërheqëse për emigrantët në përgjithësi, dhe muajt e fundit veçanërisht për qytetarët britanikë - përshtypja jonë është se kjo është e lidhur me frikën e rritjes së taksave në MB”.

Për pensionistët britanikë të tunduar për t’iu bashkuar trendit, këtu është udhëzuesi përfundimtar për vendet më të mira për të jetuar në Shqipëri, si të merrni një vizë, kostot e strehimit dhe si funksionon sistemi i kujdesit shëndetësor...

Vizat dhe përfitimet tatimore

Pensionistët britanikë mund të aplikojnë për ‘opcionin e dedikuar të vizave të daljes në pension të Shqipërisë për qytetarët jo-BE/ZEE’, shpjegon William Cooper, drejtor marketingu në firmën e huaj “William Russell”.

Ai thotë: “Hapat fillestarë të aplikimit përfshijnë marrjen e një vize ‘D’, e cila lejon një qëndrim të zgjatur ndërkohë që aplikimi juaj për qëndrim është përpunuar.

“Më pas, ju mund të aplikoni për leje qëndrimi përmes portalit e-Albania. Për ta bërë këtë, zakonisht duhet të përfshini vërtetimin e akomodimit, dëshminë e mjeteve tuaja të mjaftueshme financiare dhe mbulimin e sigurimit shëndetësor”.

Për të siguruar vizën, pensionistët do të duhet të demonstrojnë se kanë “të ardhura të rregullta mujore nga pensioni prej të paktën

“Daily Mail”: Si të dilni në pension në Shqipëri, ‘Maldivet e Evropës’



120,000 lekësh shqiptare (1,011 £/1,271 dollarë)”, thotë William.

Për sa i përket përfitimeve tatimore, ekspertët e “Magic Towns” shpjegojnë se për pensionistët e huaj në Shqipëri, “të ardhurat nga pensionet, përfshirë pensionet shtetërore, private dhe të huaja, janë zakonisht pa taksa”.

Politika dhe kultura

Shqipëria ishte nën sundimin e një diktature komuniste nga viti 1946 deri në fillim të viteve 1990. Në këtë kohë ajo ishte e

mbyllur dhe e njohur si “Koreja e Veriut e Evropës”.

Gjërat kanë ndryshuar shumë që atëherë dhe Shqipëria është tani një demokraci parlamentare me një president si kreu i shtetit dhe një kryeministër në krye të qeverisë. Kryeministër aktual është Edi Rama, i cili është në këtë rol që nga viti 2013.

Shqipëria është një vend laik pa fe zyrtare, por në regjistrimin e vitit 2023 të kryer nga Instituti i Statistikave, 53 për qind e popullsisë identifikohen si myslimanë, 16 për qind si të krishterë, 17 për qind si jofetarë dhe 16 për qind si të padeklaruar.

Jennifer në “International Living” thotë për MailOnline:

“Shqipëria vuan nga keq perceptimet e vjetruara. Njerëzit dëgjojnë “Shqipëri2 dhe mendojnë “A nuk ishte një vend post komunist - a është akoma?”. Megjithatë, është një shtet demokratik që nga fillimi i viteve ‘90. Është një vend miqësor për të shkuar ku mund të shijoni një cilësi të lartë jete për një çmim relativisht të ulët”.

Vendi ka ‘numrin më të lartë të kafeneve për frymë në botë’, shpjegon Sara në “Magic Towns”, e cila shton se është e lidhur mirë me Britaninë e Madhe, me fluturime direkte për në Londër Heathrow, Luton dhe Stansted, si dhe në Birmingham dhe Manchester nga Aeroporti i Tiranës.

Strehimi dhe vendi ku të jetoni

Ekspertët e emigrantëve në “Magic Towns” shpjegojnë se tregu i pronave në Shqipëri “ofron një gamë të larmishme opsionesh”, nga komplekset e apartamenteve me porta luksoze deri te shtëpitë e stilit otoman dhe shtëpitë e stilit italian të ‘kalim shekullit’. Ata thonë se Tirana - kryeqyteti - dhe dy pika bregdetare - Vlora dhe Saranda - janë opsione të shkëlqyera për pensionistët.

Tirana

Sara në “Magic Towns” tregon për “MailOnline”: “Si kryeqytet, Tirana ka infrastrukturën më të mirë, shumë investime të fundit dhe mundësitë më të shumta të kujdesit shëndetësor dhe arsimit. Do të thosha se është një zgjedhje e shkëlqyer për pensionistët që gëzojnë një mënyrë jetese aktive, me shumë kafene, restorante, bare dhe ngjarje kulturore”.

Kostoja: “Një apartament me një dhomë gjumi kushton rreth 400-700 euro/332-582 £/418-732 dollarë në muaj në qendër të qytetit, ndërsa jashtë qendrës është më afër 250-500 euro/207-415 £/261-523 dollarë. Çmimet e pronave variojnë nga 1500-3000 €/1247-2495£/1569-3139 dollarë për metër katror.





Vlora

Sara shpjegon: “Vlora është një qytet bregdetar përgjatë rivierës së famshme shqiptare dhe destinacioni i përsosur për pensionistët që duan të jetojnë buzë detit. Ka një komunitet emigrantësh në rritje, një lungomare (shëtitore bregdetare) të sapo zhvilluar dhe akses të lehtë në disa nga plazhet më të bukura të Shqipërisë. Është më e qetë se Tirana, por ende ka gjithçka që ju nevojitet, duke përfshirë një qendër urbane. Në verë bëhet më e gjallë, por edhe e mbushur me turistë dhe vendas”.

Kostoja: Çmimet ndryshojnë në bazë të afërsisë me detin, por pronat buzë detit mund të arrijnë 1200-2500 € / 998-2079 £ / 1255-2616 dollarë për metër katror. Qiraja është përgjithësisht 20-30

për qind më e ulët se Tirana.

Saranda

“Saranda është më e ngrohta nga të tria dhe prej kohësh është e preferuara për pensionistët”, shpjegon Sara. Ajo shton: “Ka një ndjesi të ngjashme me Vlorën, me pamje të mrekullueshme bregdetare dhe atë atmosferë të këndshme që prisni nga një qytet bregdetar. Ajo gjithashtu ka qasje të drejtpërdrejtë me traget në Korfuz, Greqi. Dimrat janë shumë më të qetë, pasi është më shumë një destinacion sezonal”.

Kostoja: Çmimet ndryshojnë në bazë të afërsisë me detin, por pronat buzë detit mund të arrijnë 1200-2500 € / 998-2079 £ / 1255-2616 dollarë për metër katror. Qiraja është zakonisht 20-30 për qind më e ulët se Tirana.



Kostoja e jetesës

Sipas Numbeo, kostoja mesatare e jetesës në Shqipëri është 50 për qind më e ulët se në MB, ndërsa qiraja është rreth 70 për qind më e ulët. Kostoja e jetesës është gjithashtu 11 për qind më e ulët në Spanjë, një destinacion popullor britanik i daljes në pension.

Sara shpjegon se një vakt në një restorant të nivelit të mesëm mund të kushtojë 8-15 euro / 6,65-12,48 £ / 8,37-15,70 dollarë për person, ndërsa kafeja zakonisht është nën 1,83 euro / 1,05 dollarë.

Ajo shton se një çift mund të shpenzojë lehtësisht 250-400 euro / 207-332 £ / 261-418 dollarë në muaj për sende ushqimore, në varësi të stilit të jetesës, ndërsa energjia elektrike, uji dhe interneti zakonisht kushtojnë rreth 100 euro / 83 £ / 104 dollarë në muaj.

Kujdesi shëndetësor

William, në “William Russell”, shpjegon: “Shqipëria operon një sistem shëndetësor universal të financuar nga kontributet e detyrueshme dhe vullnetare, të plotësuara nga buxheti i shtetit”.

Ai paralajmëron se “cilësia e kujdesit shëndetësor publik mund të ndryshojë” dhe objektet mund të jenë të kufizuara jashtë Tiranës.

Megjithatë, eksperti shpjegon se “kujdesi privat shëndetësor ka pasur rritje të konsiderueshme” dhe objektet zakonisht “sigurojnë një standard më të lartë kujdesi”.

Ai thotë se pensionistët duhet të blejnë sigurime shëndetësore private ndërkombëtare dhe të mendojnë të lëvizin diku me objekte



mjekësore afër, gjë që mund të mos jetë rasti në zonat rurale.

“Ne thjesht ramë në dashuri me njerëzit dhe bukurinë e vendit”


Banorët miqësorë dhe të përzemërt të Shqipërisë janë një nga arsyet që Deborah dhe James Riley, të dy në të 70-at, po shijojnë pensionin në një fshat jashtë qytetit-port të Durrësit. Ata u shpërngulën në vend nga Bloomington, Indiana, në vitin 2020. Deborah thotë për “MailOnline”: “Sapo erdhëm këtu, gjetëm një ngrohtësi, dashuri dhe miqësi të tillë. Ne thjesht ramë në dashuri me njerëzit dhe bukurinë e vendit”.

James shton: “Ata janë shumë mikpritës për njerëzit nga vende të tjera. Ne kemi blerë shtëpinë tonë nga vëllezërit dhe ata janë shumë të mëshirshëm e bujarë me ne, sepse ne jemi një çift më i vjetër. Ndodhi një përmbytje e madhe dy javë më parë që shkatërroi motorin e automjetit tim. Kështu që unë thashë “Nuk kam vërtet para të mjaftueshme për këtë problem tani”, dhe ai tha: “Oh, unë do ta blej për ju. Ju më paguani më vonë”.

Çifti shpjegon se ata mund të shpenzojnë deri në 7 dollarë / 5,56 £ në ditë për ushqim, i cili përfshin ushqim për katër kafshët e tyre shtëpiake dhe kafshët e tjera në lagje.

Deborah zbulon: “Të gjithë kanë shumë fruta dhe perime që rriten në oborret e tyre, dhe kështu çdo gjë është e freskët në dyqanet e vogla ku shkoni të blini perime. Kemi portokall, limon, shegë dhe ullinj. Ne kemi rukola gjatë gjithë vitit plus trëndafila”.

James shton: “Shqipëria është një nga vendet më të bukura që do të shkosh ndonjëherë. Mund të udhëtoni për një orë dhe do të gjeni kaq shumë larmi. Dhe pastaj një orë më tej dhe diçka ndryshe. Në fshatin tonë të vogël, mund të ecësh në rrënojat e një kishe bizantine...”.



QPR ka filluar regjistrimin për ushtarë/detarë aktiv. Stërvitja Individuale Bazë do të zhvillohet në periudhën 28.04.2025 - 04.07.2025. Afati i dorëzimit të dokumentacionit është deri më 31 mars 2025. Apliko në: <https://www.mod.gov.al/karriera-2/1008-si-te-rekrutohem-ushtar-detar-aktiv-ne-fa>